



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT I VEÇANTË

PËR GJENDJEN E TË DREJTAVE TË
MINORITETEVE NË SHQIPËRI

Tiranë, Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

1. **Hyrje**
2. **Baza ligjore për garantimin e të drejtave të minoriteteve**
3. **Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.**
4. **Disa të dhëna të tjera mbi minoritetet dhe komunitetet e tjera në Shqipëri**
5. **Problematikat e konstatuara nga inspektimet e Avokatit të Popullit, në vendbanimet kryesore të minoriteteve dhe komuniteteve te tjera**
6. **Te drejtat e femijeve ne minoritete dhe komunitete te tjera**
7. **Karta Europiane e gjuhëve Krahinore ose Minoritare**
8. **Informacion mbi propozimet dhe rekomandimet për çështjet e minoriteteve në vend.**
9. **Konkluzione dhe Rekomandime**

1. Hyrje

Që në hyrje të këtij raporti do të donim të citonim pohimin e artikuluar që në vitin 1930, nga ana e Dhomës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare, në të cilin thuhet se: "Ekzistenca e një minoriteti është një çështje fakti dhe jo një çështje e së drejtës, jo një çështje thjesht juridike".

Në këtë kuptim, ekzistenca e minoriteteve në Shqipëri është një realitet sa historik aq edhe aktual, të cilit i është kushtuar një vëmendje e veçantë për të konkretizuar një marrëdhënie të mirë, ku shprehet toleranca, bashkëjetesa dhe mirëkuptimi mes pjestarëve të pakicave përkatëse dhe pjesës tjetër të popullatës. Ky kujdes i kultivuar në mentalitetin e shoqërisë shqiptare, me elemente diversiteti si pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, ka reflektuar një bashkëjetesë harmonike dhe tolerante, pa prezencën e konflikteve etnike, racore, apo fetare.

Me vendosjen e demokracisë në vend, trajtimi i pakicave ka marrë një dimension të ri, fakt që duket qartë në angazhimet që shteti shqiptar ka ndërmarrë për këtë qëllim.

Sot në Shqipëri njihen dy lloje minoritetesh, minoritetet etnike kombëtare ku përfshihet minoriteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazez, si dhe minoritetet etno gjuhësore, ku përfshihen minoriteti Vllah dhe minoriteti Rom. Pavarësisht kësaj realiteti i shoqërisë sonë njeh "de facto" edhe disa komunitete të tjera të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare siç janë komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian, apo edhe komuniteti Goran.

Në fakt Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 20, shprehet vetëm për personat që u përkasin pakicave kombëtare gjë që krijon edhe një debat në lidhje me njohjen e zgjeruar nga ana e shtetit edhe të kategorisë së minoriteteve etno gjuhësore.

I gjithë diskutimi në këtë aspekt përqendrohet në dy drejtime, së pari, nocioni juridik i përcaktimit të minoritetit dhe së dyti, vullneti shtetëror i shprehur formalisht në njohjen zyrtare të komuniteteve të caktuara që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që efektivisht janë shtetas shqiptarë, por që kanë elementë të jetesës dhe trashëgimisë të tyre të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare.

Sa i takon nocionit juridik të përcaktimit të një përkufizimi mbi minoritetet mund të thuhet se, ekzistenca e një shumice tekstesh ndërkombëtare, por edhe e një sërë aktesh ndërkombëtare që trajtojnë këtë fushë, nuk japin ndonjë përkufizim të përgjithshëm të nocionit të minoritetit, ku mund të përfshiheshin të gjitha grupet e ndryshme minoritare. Përvoja ndërkombëtare ka treguar nga ana tjetër se është e vështirë të jepet një përkufizim, ku mund të përfshihen të gjitha kategoritë e minoriteteve, për shkak të larmisë së madhe të grupeve minoritare dhe të vështirësive objektive për t'i klasifikuar ato në mënyrë homogjene. Kjo gjë ka ndikuar edhe në mungesën e një përkufizimi të përgjithshëm mbi minoritetet në aktet ndërkombëtare.

Megjithatë mungesa e këtij përkufizimi nuk ka penguar shtetet e ndryshme, sikurse edhe Shqipërinë të njohin kategori të caktuara minoritetesh bazuar në tregues të natyrës objektive dhe subjektive të komuniteteve të caktuara në vend. Elementët objektivë lidhen me ekzistencën, brenda një shteti të caktuar, të grupeve të veçanta të popullsisë që kanë karakteristika etnike, fetare e gjuhësore të qëndrueshme. Kurse elementët subjektivë lidhen me vullnetin për të ruajtur karakterin e veçantë të grupit, fakt që shman

asimilimin. Mbi këtë bazë vlerësimi, e cila referohet në një protokoll të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të vitit 1993, ku bëhet një tentativë për dhënien e një përkufizimi mbi minoritetet,¹ përcaktohet edhe fakti se, grupet që i pohojnë dallimet e tyre gëzojnë një trajtim special, ndërsa grupet e asimiluara mbeten jashtë këtij trajtimi.

Njohja e minoriteteve nxjerr nevojën edhe të mbrojtjes së tyre, përmes afirmimit të një sërë të drejtave që u njihen posaçërisht atyre. Sa i takon realitetit tek ne mbi këto të drejta, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka sanksionuar në nenin 3 të saj, pluralizimin, identitetin kombëtar dhe trashëgiminë ka sanksionuar parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pavarësisht përkatësisë së individit në pakicën përkatëse. Për më tepër, në nenin 20 të saj, në mënyrë eksplicite parashikohet që personat të cilët u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar, as detyruar përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore, si dhe kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato. Kushtetuta iu ka njohur edhe të drejtën të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

Anëtarësimi i Shqipërisë në një sërë organizatash dhe organizmash ndërkombëtarë me fushë veprimtarie mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe ratifikimi, apo nënshkrimi i një numri të konsiderueshëm aktesh ndërkombëtare të qëllimura në afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht në referencë të minoriteteve, ratifikimi pa asnjë rezervë i Konventës Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", flasin për një angazhim serioz institucional. Që prej 13 Korrikut të vitit 1995, Shqipëria është vend anëtar i Këshillit të Europës, gjë që flet për këtë angazhim.

Zhvillime pozitive janë evidentuar edhe në kuadër të plotësimit të kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të gjithë procesit në vazhdim për anëtarësimin e vendit në BE, ndërkohë që si një hap i rëndësishëm institucional mund të vlerësohet ngritja e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve,² si institucion qëndror me natyrë konsultative, në varësi të Kryeministrit.

Efektivisht sot, shoqëria shqiptare ka vendosur një balancë pozitive përsa i përket çështjes dhe respektimit të të drejtave të pakicave, duke u renditur ndër shtetet, të cilat janë angazhuar në përmbushje të standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. Zbatimi në praktikë i parashikimeve të akteve themelore, por edhe zbatimi i akteve ndërkombëtare dhe veçanërisht i përcaktimeve të Konventës Kuadër të Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare", ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e të drejtave të pakicave.

Por pavarësisht parashikimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare që

¹ Ky protokoll është një akt jo detyrues për shtetet anëtare të Këshillit të Europës, pasi nuk u miratua nga ana e Komitetit të Ministrave.

² Ky komitet është ngritur bazuar në parashikimet e bera në VKM nr.127 date 11.03.2004. Këshilli i Ministrave vendosi krijimin e këtij komiteti për të nxitur me tej pjesëmarrjen e personave, që u përkasin minoriteteve në jetën publike, si dhe për të sugjeruar masa për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre.

janë në fuqi, të gjithë jemi të vetëdijshëm, që ka shumë për të bërë, për të garantuar në praktikë, respektimin e të drejtave, integritimin dhe përfshirjen sociale, të pakicave që jetojnë në vendin tonë. Në këtë drejtim, roli i Avokatit të Popullit merr një rëndësi të veçantë.

Në fakt, të drejtat e minoriteteve, nuk ishin të përfshira për disa kohë në listën e të drejtave të njeriut, ndërkombëtarisht të njohura. Kjo situatë ka ndryshuar materialisht vetëm gjatë dekadës së fundit, ndërkohë që emancipimi për të drejtat e minoriteteve nuk mund të konsiderohet si i zgjidhur përfundimisht madje edhe sot.

Një kujdes i posaçëm i është kushtuar nga ana jonë të drejtave të minoritetit Rom, që jeton në Shqipëri, i cili konsiderohet si minoritet etno gjuhësor. Popullsia Rome në një pjesë të madhe nuk figuron e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, fenomen i cili është më i përhapur për personat e lindur pas viteve '90. Ndërhyrjet e Avokatit të Popullit për të drejtat e këtij minoriteti kanë qënë konstante në vite, por ndërkohë duhet theksuar se, vitet e fundit mund të konsiderohen si vitet ku përparësi në punën e institucionit kanë patur të drejtat e këtij minoriteti, të trajtuara në një këndvështrim shumëplanësh. Ky aktivitet ka konkluduar me disa rekomandime drejtuar organeve të administratës publike, në nivel vendor dhe qendror, si dhe me përgatitjen e një raporti të veçantë drejtuar Kuvendit, në lidhje me problematikat e komunitetit Rom, në Shqipëri. Vizioni i institucionit të Avokatit të Popullit ka përfshirë një bashkëpunim të gjerë dhe të ngushtë me OJF-të që veprojnë në vend, në kuadër të të drejtave të Romëve.

Vlerësojmë se, veç impaktit institucional, një nga treguesit më pozitivë të arritur gjatë këtyre ndërhyrjeve institucionale është padyshim, sensibilizimi mbarëshoqëror dhe i medias, në lidhje me problematikat që, sot shqetësojnë minoritetin Rom në Shqipëri. Realisht veprimi më kuptimplotë që kreu Avokati i Popullit për sensibilizimin mbi gjendjen e të drejtave të këtij minoriteti, ka qënë strehimi simbolik disajavor i disa familjeve rome në ambientet e zyrave të institucionit tonë, në fillim të vitit 2012. Megjithatë në dukje një veprim kontraversal, është i pari akt që flet qartë për rolin që ka institucioni, rrugët që ai mund të ndjekë për mbrojtjen e të drejtave të individëve pjestarë të pakicave dhe këndvështrimin real, që duhet të ketë trajtimi i problematikave të këtij minoriteti.

Zbatimi i parimeve të qeverisjes së mirë, luan një rol jetik në përfshirjen e minoriteteve në shoqërinë tonë, por edhe në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Përmes njohjes, dialogut dhe pjesëmarrjes, të gjithë qytetarët e një shoqërie të larmishme, mund të formojnë një kuptim më të madh të shqetësimeve të njëri-tjetrit. Edhe në këto çështje, autoritetet vendase të të drejtave të njeriut, por edhe ligjvënësit, qeveritë, shoqëria civile dhe mediat, kanë rol të rëndësishëm për të luajtur. Në këtë drejtim roli i Avokatit të Popullit merr një rëndësi të veçantë, pasi vështirë të gjejmë një institucion tjetër që mund të merret më shumë se sa ai, mbi idenë se, të dobët kanë nevojë për t'u mbrojtur nga të fuqishmit dhe të pushtetshmit.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik "Për Avokatin e Popullit", veprimtaria e Avokatit të Popullit lidhur me respektimin e të drejtave të minoriteteve, apo pakicave në këto vite është bazuar kryesisht në investigimet "ex-officio", që ai ka ndërmarrë kohë pas kohe për këtë qëllim. Kjo mënyrë veprimi është kondicionuar edhe për faktin se numri i ankesave që vijnë nga individë pjestarë të pakicave, ka rezultuar të jetë i ulët.

Për këtë arsye, Avokati i Popullit është prirur që të gjendet sa më afër këtyre komuniteteve, duke shkuar dhe kontaktuar me individët që i përkasin atyre, në vendet e banimit, qoftë në raste individuale, apo edhe nëpërmjet organizimit të ditëve të hapura në zonat e tyre të njohura të banimit.

Në lidhje me minoritetet kombëtare, vërejmë se, pavarësisht bazës normative ligjore në fuqi mungon përkufizimi i minoritetit kombëtar. Aktualisht procesi i njohjes së këtyre minoriteteve në vend, bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare, siç janë kriteret objektive që kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, linguistike të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, si dhe me shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qënë pjesë e minoritetit. Konventa Kuadër e Këshillit Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, siç përcaktohet edhe në Opinionet përkatëse të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës,³ nuk është e vetëzbatueshme, por ka nevojë për adoptimin e masave të tjera ligjore dhe nënligjore për të bërë të mundur zbatimin e dispozitave të saj. Kjo Konventë nuk përcakton ndonjë përkufizim, në bazë të të cilit kryhet njohja e minoriteteve, por e lë këtë gjë në dëshirën e shteteve anëtare të Këshillit të Europës, që të kryejnë rregullimin e këtij aspekti nëpërmjet akteve ligjore të brendshme, në varësi të konfigurimit respektiv të minoriteteve në çdo vend. Siç edhe rezulton, vendi ynë nuk ka nxjerrë ende asnjë akt normativ të brendshëm ku të përcaktohet definicioni, apo kriteret e njohjes së minoriteteve, të cilat “de jure”, njihen nga shteti shqiptar. Në këto kushte është i nevojshëm rregullimi me një ligj specifik, i cili do të parashikojë shprehimisht këtë moment. Ky ligj do të ketë efektet e tij dhe do të kërkojë edhe reflektim në dispozitat ligjore të një sërë ligjesh të tjera në fuqi, që do të sigurojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim sa më real dhe aktiv të minoriteteve në Shqipëri.

Në kuadër të plotësimit të bazës ligjore rregullatore mbetet kërkesë edhe nënshkrimi nga ana e Qeverisë, i Kartës Europiane “Për gjuhët rajonale ose minoritare”.

Sfidat e ndeshura në implementimin e të drejtave të pakicave janë të shumta. Ato fillojnë që nga mundësia reale e vetë institucionit të Avokatit të Popullit për të qënë prezent në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndjeshme pranë tyre, aty ku ato ndodhen; të krijimit të besimit të ndërsjellë mes aktorëve që veprojnë në këtë fushë; të ndryshimit të mentalitetit, lidhur me pranimin e realiteteve të reja dhe respektimin e të drejtave të individëve që i përfaqësojnë ato; të krijimit të një ambienti të përshtatshëm institucional që mundëson barazinë reale të individëve pjestarë të minoriteteve të ndryshme me pjesën tjetër të popullsisë në vend dhe të integritetit të tyre.

Një sfidë tjetër është shmangia e fushatave propagantistike të përkohëshme dhe të pavlera dhe formësimi i një procesi të vazhdueshëm të

³ Komiteti Këshillues i Këshillit të Europës për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve ka theksuar në tre opinionet e tij, nevojshmerine e adoptimit të një ligji specifik për minoritetet. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, në Rezolutën e tij RESCMN (2005)2 dhe në atë të vitit 2009, thekson nevojën për zhvillimin e metejshëm të kuadrit ligjor dhe administrative për minoritetet, sidomos për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetit të tyre, arsimimin, diskriminimin, mediat, përfaqësimin në jetën publike etj. Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës ka rekomanduar në raportet e tij, gjithashtu, adoptimin e një ligji të tillë.

pandërprerë për monitorimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe mundësimin e ushtrimit të tyre.

Në të gjitha iniciativat dhe rekomandimet tona kemi theksuar se, elementët më kryesorë në zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballlet sot shoqëria shqiptare janë dialogu konstruktiv dhe i vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi ndërkulturor ndërmjet, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe qytetarëve, me qëllim që adresimi i problematikave dhe procesi i analizimit dhe zgjidhjes së tyre të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar. Kjo mënyrë mendimi dhe veprimi n'a afron gjithnjë e më shumë me komunitetin European, ku edhe aspirojmë të anëtarësohemi së shpejti.

Duke mos qenë i vetëm në llojin e institucioneve të pavarura, të ngritura në mbrojtje të të drejtave të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit duhet të tregojë individualitet të spikatur në rolin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të individit, gjë që realisht përbën një tjetër sfidë në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve. Respektimi i të drejtave të minoriteteve është pjesë e rëndësishme e axhendës europiane të vendit tonë, prandaj ne duhet synojmë të bëhemi pjesë e familjes së madhe europiane, jo vetëm duke u përputhur institucionalisht, por dhe me praktikën dhe legjislacionin edhe për të drejtat e minoriteteve.

Nisur nga ky rol specifik, hartimi dhe përgatitja e këtij raporti është bazuar në të dhënat e vet institucionit mbi çështjet e minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend, të dhëna zyrtare, si dhe nga të dhëna të mbledhura gjatë inspektimeve që punonjës të institucionit kanë kryer në zonat kryesore të vendit ku ka prezencë të dallueshme minoritare, apo të komuniteteve të tjera. Këto inspektime janë kryer në zonën e Dropullit (Gjirokastrë), fshatin "Andon Poçi" (Gjirokastrë), komunën Pustec, (Korçë), fshatin Borakë (Shijak), fshatin Vrakë dhe Boriç (Shkodër), në Fier, (fshati Libofshë), pothuaj në të gjitha zonat e inspektuara paraprakisht për raportin mbi gjendjen e minoritetit Rom, ku ka popullsi Rome dhe Egjiptiane, në Kukës (krahina e Gorës). Kontakti i parë ka qënë me banorët e zonave, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile të zonave respektive që veprojnë në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve të tyre, për të marrë një tablo sa më reale të gjendjes së të drejtave të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend.

Baza e këtij raporti mbetet konstatimi i nivelit të respektimit të atyre të drejtave që afirmohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare". Specifikisht është pasur në fokus edhe pjesa e të drejtave të fëmijëve të minoriteteve, sa i takon kuadrit ligjor të sipërcituar.

Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe vlerëson mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, si një prej prioritetëve kryesorë në punën e tij. Vizioni i tij bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.

Procesi i anëtarësimit dhe integritetit në Bashkimin European, ka paraparë si një nga prioritetet kryesorë të Shqipërisë në këtë rrugëtim, respektimin e të drejtave civile dhe politike, të cilat kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe reformave që do të synojnë garantimin në nivele gjithnjë e më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të individit, e në veçanti të të drejtave të minoriteteve.

2. Baza ligjore për garantimin e të drejtave të minoriteteve

Në këtë pjesë do të citohen disa nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare mbi afirmimin e respektimin e të drejtave të minoriteteve të nënshkruara nga vendi, apo që ende nuk janë nënshkruar prej tij, por që kanë një rëndësi të madhe në këtë kuadër, si dhe të kuadrit ligjor të brendshëm.

Kjo ekspozitë aktesh nuk përbën një listë shteruese, por mund të shërbejë si një listë orientuese, pasi një sërë përcaktimesh kryesore që rrjedhin kryesisht nga aktet ndërkombëtare janë “përthithur” plotësisht, si në Kushtetutë, ashtu edhe në legjislacionin e brendshëm normativ, në shkallë hierarkike normative më të ulët se sa konventat ndërkombëtare.

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.***

Ky akt bazë normativ për funksionimin e shtetit përbën garancinë kryesore për afirmimin dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve në vend, me përcaktimin e dhënë në nenin 3 të saj, ku si bazë e shtetit cilësohet ndër të tjera edhe “bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat” dhe duke përcaktuar si detyrim “respektimin e dhe mbrojtjen e këtyre vlerave”.

- ***Konventat Ndërkombëtare, (akte të tjera ndërkombëtare)***

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (Kombet e Bashkuara, viti 1948. Vendi ynë e ka nënshkruar në vitin 1955)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, viti 1966. (ratifikuar në vitin 1991)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, viti 1976.(ratifikuar në vitin 1991)
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e Këshillit të Europës dhe Protokollet n° 1,2,4,6, 7 dhe 11, të saj.
- Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”, viti 1995, ratifikuar pa asnjë rezervë me Ligjin nr.8496 datë 3.06.1999 “Për ratifikimin e “Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”.
- Konventa Europiane mbi Televizionin Ndërkufitar, viti 1995, ratifikuar me ligjin nr.8525 datë 9.09.1999.
- Konventa kundër Torturës, dhe Trajtimit Çnjerëzor, Degradues apo Ndëshkues, hyrë në fuqi pas ratifikimit në vitin 1994.
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, viti 1969 (ratifikuar në vitin 1994).
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike, viti 1966.
- Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, viti 1976.(ratifikuar në vitin 1991)
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas, viti 1980. (ratifikuar në vitin 1996)
- Konventa nr.168 e ILO “Për inkurajimin e punësimit dhe mbrojtjen kundër papunësisë”, viti 1988, ratifikuar me ligjin nr.9547/2006.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, viti 1989. (ratifikuar në vitin 1992)

- Konventa kundër Diskriminimit në Edukim, viti 1960.
- Konventa e UNESCO “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e manifestimit të diversitetit kulturor”, ratifikuar me ligjin nr.9613/2006.
- Konvenat e Këshillit të Europës “Për veprimet kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, ratifikuar me ligjin nr.9642/2006.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071/2009.
- Karta Europiane “Për gjuhët rajonale ose minoritare”.
- Akti Final i Konferencës së Helsinkit, viti 1975.
- Deklarata e Kopenhagenit, viti 1990.
- Karta e Parisit për një Europë të Re, viti 1990.
- Dokumenti i Konferencës së Moskës, viti 1991.
- Opinionet ACFC/OP/II(2008)003 dhe ACFC/OP/III(2011)009) të Komitetit Këshillues të Këshillit të Europës për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve.
- Rezoluta CM/ResCMN(2014)1 e Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Europës.

Akte ligjore të brendëshme:

- Ligji nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji nr.10019/2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr.10039/2008 “Për ndihmën juridike”.
- Ligji nr.10221 datë 4.02.2010 “Për Mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.127 datë 11.03.2004 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve”, i ndryshuar.
- Plani Kombëtar i MSA-së - Te drejtat e minoriteteve dhe mbrojtja e minoriteteve”, (miratuar me VKM nr.463 date 5.07.2006, i ndryshuar me VKM nr.577 date 5.9.2007).
- VKM nr.396 date 22.08.1994 “Për arsimimin në gjuhën amëtare të personave të pakicave”.
- Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom
- Dekada e përfshirjes së Romëve-Plani Kombëtar i veprimit, 2010-2015, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1087/2009.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.107 datë 10.02.2010 “Për publikimin, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore për sistemin arsimor parauniversitar”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.51 datë 2.02.2012 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe totale 45 000 m2, pjesë e pronës nr.117, me emërtim “Kompania e zbulimit, raketave Kt, të BRRSH”, me vendndodhje në Sharrë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin

nr.515 datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.

Një akt shumë i rëndësishëm, krahas akteve të tjera ndërkombëtare për afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve është Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, e cila evidenton vëmendjen e posaçme që ky organizëm i ka kushtuar kësaj çështjeje.

Fillimi i ekzistencës institucionale të Këshillit të Europës, kohëzon edhe me anagazhimin e Asamblesë Parlamentare të këtij këshilli për një mbrojtje më të gjerë të të drejtave të minoriteteve. Ishte Asambleja, struktura përkatëse e KE-së, që në vitin 1961 shtroi çështjen e një protokolli shtesë, për një trajtim më të gjerë të çështjes së minoriteteve që do trajtonte edhe më tej këtë dimension se sa Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Është pikërisht ky protokoll akti që, i hapi rrugën trajtimit më të gjerë dhe më të plotë të çështjes së minoriteteve, deri tek hartimi dhe miratimi i Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, si shprehje e nevojës të angazhimit ndërkombëtar për të kontribuar për paqen dhe stabilitetin.

Kjo konventë ka cilësimin si konventë kuadër, pasi u jep mundësinë shteteve që të kuptojnë dispozitat e saj, duke u bazuar në situatën specifike të vendit të tyre.

Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, është instrumenti i parë shumëpalësh, juridikisht i detyrueshëm me objekt mbrojtjen e minoriteteve. Qëllimi i saj është përcaktimi i parimeve juridike që shtetet marrin përsipër për të siguruar mbrojtjen e minoriteteve kombëtare, por duke patur një karakter programor, ajo shërben edhe si një kornizë për trajtimin e situatave dhe problemeve të ndryshme të parashtruara në shtete të veçanta, duke u lënë këtyre të fundit një marzh veprimi sipas rrethanave konkrete.

Konventa, megjithëse i referohet të drejtave kolektive të minoriteteve kombëtare, nuk jep ndonjë përkufizim të termit “minoritet kombëtar”. Çdo Pale në Konventën Kuadër megjithatë i është lënë hapësirë për të vlerësuar se cilat grupe mund të përfshihen nga Konventa brenda territorit të tyre. Ky seleksionim megjithatë duhet të bëhet me qëllim të mirë, dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, dhe parimet themelore të përcaktuara në Nenin 3 të Konventës Kuadër.

Sipas konventës, individët janë të lirë të vendosin nëse dëshirojnë apo jo, të bëjnë pjesë në një minoritet kombëtar. Kjo nuk nënkupton se, çdo person mund të vendosë në mënyrë arbitrare nëse i takon ndonjë minoriteti kombëtar. Zgjedhja e individit duhet të bazohet në kriterë objektive, që lidhen me identitetin e personit, siç janë gjuha, feja dhe kultura.

Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, u nënshkrua nga Republika e Shqipërisë në 29.06.1995. Ajo u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8496 datë

3.06.1999, dhe pasi u depozituan instrumentet e ratifikimit në 28.09.2000, hyri në fuqi në 1.01.2001.⁴

4. Minoritetet sipas statistikave zyrtare.

Sikurse është theksuar më lart, në vendin tonë njihen zyrtarisht dy lloje minoritetesh, minoritetet etnike kombëtare dhe minoritetet etno gjuhësore. Ky proces ka qënë evolutiv me kohën, sikurse edhe mbledhja e të dhënave për ekzistencën e minoriteteve dhe metodologjia e mbledhjes së tyre, ka patur të njëjtin karakter evolutiv. Sipas të dhënave të mbledhura nga ana e shtetit shqiptar në periudha të ndryshme mbi numrin e popullsisë që i takon minoriteteve, vërehet se janë përdorur Censuset mbi popullsinë dhe banesat të kryera nga institucione shtetërore specifike, sikurse Instituti i Statistikave (INSTAT).

Sipas disa censuseve të kryera në periudha të ndryshme kohore, numri i popullsisë që i takon vetëm minoriteteve kombëtare në vend rezulton të jetë:

Viti 1960	44.570 (individë)	2.7 % (e popullsisë në total, në Shqipëri)
-----------	-------------------	--

Viti 1979	54.687	2.1%
-----------	--------	------

Viti 1989	64.816	2.0% ⁵
-----------	--------	-------------------

Pra, sipas këtyre statistikave në raportim nuk përfshihet numri i popullsisë që i takonte në atë kohë komunitetit Rom dhe atij Vllah.

Në muajin Prill 2001, u ndërmor një census i ri mbi popullsinë dhe banesat në vend, i cili nuk përfshiu deklarimin e kombësisë dhe besimit fetar.⁶

Ndërkohë në censusin e zhvilluar në vitin 2011, janë përfshirë edhe cilësimi për minoritete etno linguistike Rome dhe Vllahe dhe sipas këtij censusi, minoritetet rezultojnë me 52.700 individë në Shqipëri, ose 1.9 të numrit të popullsisë në vend.

Sipas të dhënave të nxjerra nga ky census mbi popullsinë banuese sipas përkatësisë etnike dhe kulturore, rezulton:

Minoriteti Grek	24.243 (individë)
-----------------	-------------------

Minoriteti Maqedonas	5.512
----------------------	-------

Minoriteti Malazez	366
--------------------	-----

Minoriteti Arumun (Vllah)	8.266
---------------------------	-------

Minoriteti Rom	8.301 ⁷
----------------	--------------------

Në formularin e regjistrimit të popullsisë, të realizuar në vitin 2011, u përfshi edhe pyetja mbi përkatësinë etnike, që nënkupton vetdeklarimin si një kriter për identifikimin e përkatësisë etnike të popullsisë.

Një zhvillim jurisprudencial i cili krijoi debat sidomos në grupet përfaqësuese apo shoqatat e minoriteteve në vend, gjatë kohës që po bëheshin përgatitjet për zhvillimin e censusit të vitit 2011, ka qënë Vendimi nr 52, datë 1.12.2011, i Gjykatës Kushtetuese, ku është vendosur; “Shfuqizimi si i

⁴ Report submitted by Albania pursuant to Article 25, paragraph 1 of the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 26 Korrik 2001, faqe 4.

⁵ Report submitted by Albania pursuant to article 25, paragraph 1, of the Framework Convention for the Protection of National Minorities, 26 Korrik 2001, faqe 8.

⁶ Ibid, faqe 9.

⁷ Këto të dhëna gjenden në website: www.instat.gov.al/al/census/census-2011/te-dhenat-e-census-2011.aspx

papajtueshëm me Kushtetutën i termit “kombësi” në nenet 6/1, 8, 42/2, gërma “e” dhe i nenit 58, tërësisht, të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”.

Pavarësisht shifrave të deklaruara mbi popullsinë minoritare në këtë census, mospajtimi me to nga ana e përfaqësuesve të partive politike, apo shoqatave që mbrojnë ekskluzivisht të drejtat e minoriteteve ka qënë evident dhe publik, fakt që është konstatuar nga ana jonë edhe në takimet e zhvilluara me banorë, apo përfaqësues të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e minoriteteve, në të gjitha zonat kryesore të vendit ku ka prezencë të dallueshme minoritare, apo të komuniteteve të tjera.

5. Disa të dhëna të tjera mbi minoritetet dhe komunitetet e tjera, në Shqipëri.

*** Minoriteti Grek**

Minoriteti etnik grek është një nga pesë minoritetet, e njohura zyrtarisht nga shteti shqiptar. Ky minoritet që nga njohja e tij në kuadër të shtetit shqiptar me deklaratën e datës 21 Tetor 1921, në Lidhjen e Kombeve, ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ruatjen e identitetit të tij kombëtar, gjuhës amtare greke, traditave kulturore, dokeve dhe zakoneve. Që nga dita e përfshirjes së tij në kuadrin e shtetit shqiptar, ka treguar frymë bashkëpunimi e tolerance, ka themeluar dhe forcuar marrëdhëniet miqësore dhe ka luajtur rol pozitiv në fushën e bashkëjetesës paqësore me popullsinë shqiptare.

Pjesëtarë të këtij minoriteti historikisht kanë banuar në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë, por ai është kryesisht i përqëndruar në qarqet e Gjirokastrës (Komunat minoritare të Dropullit të Sipërm dhe Dropullit të Poshtëm dhe Pogonit) dhe Vlorës (Sarandë, Delvinë, Himarë). Në qarkun e Vlorës është i përqëndruar kryesisht në, komunat Livadhja, Aliko, Dhivër (rrethi i Sarandës) dhe komunat Finiq dhe Mesopotam (rrethi i Delvinës). Gjithashtu, këtu duket theksuar dhe ekzistenca e dy fshatrave të minoritetit grek në Përmet (Vlahopsiloterë dhe Viovizhda).

Shqipëria është një vend ku jetojnë edhe minoritete të tjera, por minoriteti grek është grupi më i madh në numër. Për numrin nuk mund të bëhet një vlerësim i saktë. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë që është bërë më 1989, gjithë popullsia e Shqipërisë arrinte në atë kohë në 3.182.400 banorë, nga të cilët, 3117600 shqiptarë dhe 58758 grekë. Sigurisht, këto të dhëna duhen azhornuar, pasi kanë kaluar vite dhe kanë ndodhur ndryshime. Ka pasur lëvizje demografike dhe një pjesë jo e vogël e popullsisë minoritare është larguar për në Greqi.

Censusi i vitit 2011, u kontestua ashpër nga organizatat e minoriteteve për shkak të pretendimeve për mosrespektim të parimit të vetëdeklarimit të lirë dhe u bënë thirrje për bojkot. Sipas të dhënave zyrtare të censurit, numri i personave që i përkasin minoritetit grek është 24243 veta, ose rreth 0.87% e numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Minoriteti grek ushtron të drejtën e tij për arsimimin në gjuhën amtare. Aktualisht në ciklin e arsimit parauniversitar në shkollat publike në rrethet e Gjirokastrës, Sarandës dhe Delvinës, ka rreth 1000 nxënës. Ekzistojnë dhe tre gjimnaze në Dervician, Bularat dhe Livadhja, ku mësimet kryesore bëhen në gjuhën shqipe, por ka dhe lëndë të gjuhës, letërsisë, historisë dhe gjeografisë

në gjuhën greke. Në Gjirokastrë funksionon edhe shkolla e mesme pedagogjike "Pandeli Sotiri", ku funksionon prej kohësh dega e greqishtes.

Gjithashtu, në Gjirokastrë në universitetin "Eqrem Cabej", funksionon prej kohësh dega e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Greke. Në Himarë dhe në Korçë, funksionojnë shkollat private "Omiros", ku një pjesë e lëndëve bëhet në gjuhën greke.

Shqipëria dhe Greqia kanë lidhur Traktatin e miqësisë, bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe sigurisë, në Mars 1996, traktat ky i cili ka sjellë një atmosferë të re në marrëdhëniet shqiptaro-greke, e reflektuar kjo pozitivisht edhe në pozitën e minoritetit grek. Ai duhet vlerësuar si një arritje e rëndësishme në interes të të dy palëve.

Në këtë Traktat çështja e të drejtave njerëzore dhe minoritare konsiderohet si pjesë e "trashëgimisë mbarëevropiane". Veç asaj në Traktat bëhet fjalë për minoritetin grek në Shqipëri dhe emigracionin shqiptar në Greqi, si një "urë e zhvillimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve midis dy palëve". Palët angazhohen të zhvillojnë marrëdhëniet në bazë të besimit, bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjelltë, si dhe shpallin përkushtimin e tyre ndaj paprekshmërisë së kufijve, duke shtuar se "vija kufitare midis dy vendeve do të jetë një vijë kufitare paqeje dhe miqësie".

Statusi dhe gjëndja e popullsisë minoritare greke në jug të vendit, ka qënë objekt kontaktesh të shpeshta midis palëve.

****Minoriteti Maqedonas***

Në Republikën e Shqipërisë, minoritarë maqedonas banojnë kryesisht në rrethin e Korçës (Komuna e Pustecit), në rrethin e Devollit (fshati Vërnik), por edhe në qytetin e Korçës, Pogradecit, Bilishtit, Tiranës, Durrësit, Bilisht, Kukës, Librazhd etj. Minoritarë maqedonas banojnë në zonën e Gollobordës (Peshkopi) dhe në zonën e Gorës (Kukës). Minoriteti maqedonas me banim në komunën e Pustecit dhe në fshatin Vërnik është njohur nga shteti shqiptar që në vitet e para të pasçlirimit (1945) me të drejtat për përdorimin e lirë të gjuhës amtare maqedonase, të shkollimit të fëmijëve deri në klasën e katërt të arsimit fillor, të ruajtjes dhe zhvillimit të traditave kulturore, zakoneve etj. Drejtuesit e përfaqësuesit e pushtetit vendor në këtë zonë kanë qënë e janë minoritarë.

Pozita e minoritetit maqedonas në Shqipëri nuk ka qënë e njëjtë historikisht, pasi për periudhën nga krijimi i shtetit shqiptar, deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, ky minoritet nuk njihej nga shteti shqiptar. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nga viti 1945 deri në 1948, kur Shqipëria kishte marrëdhënie të mira me Republikën Federale Popullore Jugosllave, është njohur zyrtarisht minoriteti maqedonas në zonën e Prespës, zonën e Gollobordës dhe në fshatin Vërnik, në zonën e Devollit.

Me demokratizimin e jetës në vend filloi proces i afirmimit dhe integritit gradual të minoritetit maqedonas. U krijuan kushte të përshtatshme për organizim dhe veprim të minoritetit maqedonas në Shqipëri, veçanërisht në aspektin e mbrojtjes së identitetit kombëtar dhe etnik, kultivimin e kulturës dhe traditën kombëtare.

Shteti demokratik, pas vitit 1991, bazuar në konventat ndërkombëtare dhe ligjet e vendit pasuroi më tej të drejtat kryesisht në fushën e arsimit, duke plotësuar kurrikulat për arsimimin e fëmijëve minoritarë maqedonas deri në klasën e tetë (me rreth 60 % të lëndëve mësimore në gjuhën amtare

maqedonase) dhe në dy vitet e para të shkollës së mesme të përgjithshme në zonën minoritare mësohet lënda e gjuhës amtare dhe letërsia. Në planet mësimore u shtua lënda “Historia e Maqedonisë”, si dhe njohuri për gjeografinë etj, të Maqedonisë.

Funksionojnë disa organizata dhe shoqata për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit maqedonas në vendin tonë.⁸ Këto shoqata në mënyrë të ndryshme përpigjen ti ruajnë tiparet më të rëndësishme të prejardhjes së tyre kombëtare, kulturën, traditën, zakonet, gjuhën, folklorin etj.

Minoriteti maqedonas ka ruajtur dhe zhvilluar kulturën e traditat e veta. Grupet folklorike të këtij minoriteti kanë marrë pjesë në shumë festivale folklorike kombëtare në kohën e monizmit, si dhe në shumë veprimtari kulturore kombëtare dhe lokale në vitet pas 1991. Zona e Prespës, me VKM nr. 80 datë 18.02.1999 është shpallur park kombëtar i kategorisë së dytë, që është më i madhi në shkallë vendi, me një sipërfaqe të përgjithshme 27750 ha. Banorët e Prespës merren kryesisht me bujqësi, blegtori e me peshkim.

Lëvizja e lirë pas vitit 1991 solli zhvillime të reja për banorët minoritarë të Prespës në të gjitha fushat e jetës, por mungesa e investimeve nuk ka lejuar përdorimin e potencialeve të mëdha të bukurisë së natyrës dhe të turizmit. Zbatimi i shumë projekteve në fushën ekonomike dhe arsimore, pritet të sjellë zhvillime të reja.

*** Minoriteti Serbo-Malazet**

Historia e egzistencës së minoritetit etnik Serbo- Malazet në dokumentat zyrtare daton nga viti 1416 dhe në vazhdim.⁹ Sikundër është konfirmuar në raportet e shtetit shqiptar, për zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”, ky minoritet është përgjithësisht i përqëndruar në zonën veriore të Shqipërisë, në qytetet Shkodër dhe Koplik, dhe në komunat Gruemirë, Vrakë etj. Megjithatë, persona që i përkasin këtij minoriteti janë të vendosur gjithashtu edhe në qarkun e Lezhës, Durrësit, Tiranës, Elbasanit, Librazhdit, Fierit etj.

Kur flitet për popullsinë sllave në Shqipëri gjatë shekullit të XIX, kemi të bëjmë me ndarje prej tre kategorish:

Kategorinë e parë e përbën ajo popullsi që ka patur shtetësi turke, pavarësisht përkatësisë fetare. Kjo popullsi ka qënë e përqëndruar në Shqipërinë e Veriut. Qëndrat më të njohura kanë qënë Shkodra, Vraça dhe Shtoji.

Kategorinë e dytë të popullsisë sllave në Shqipëri e përbën popullsia e cila gjatë shekullit të XIX u shpërngul në Shqipëri, shumica për arsye ekonomike. Sipas të dhënave që egzistojnë nga ajo periudhë, nga Mali i Zi dhe Serbia emigruan me qindra banorë.

⁸ Mbas vitit 1991 u krijuan këto shoqata, ne Prespe u krijua Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të Maqedonasve në Shqipëri “Drushtvo Prespa”, ne Tirane shoqata “Brastvo” dhe “MIR”, ne Gore shoqata “Gora”, dhe ne rrethin e Devollit shoqata “MED. Këto katër shoqata maqedonase në mars 2002 formuan Unionin e Maqedonasve në Shqipëri dhe në qershor të vitiit 2005 u krijua partia Aleanca e maqedoansve për integrim europian. Më vonë janë krijuar edhe shoqata të tjera si shoqata “Ilinden” ne Tiranë, shoqata “Sonce” ne Korce, si dhe shoqata “Most” në Trebishtë, të Gollobordës.

⁹ Webiste: st.glovara.com/dip_upload/UV10002391_158085.pdf

*Kategorinë e tretë të popullsisë me origjinë sllave në Shqipëri, e përfaqësojnë myslimanët të ardhur nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina.*¹⁰

Përkatësia fetare e këtyre njerëzve është gjithashtu e larmishme. Në Shkodër ekzistojnë ato me përkatësi fetare ortodokse që kryesisht jetojnë në qytet dhe në Komunën e Gruemirës, ndërsa ka dhe popullsi myslimane të ardhura gjatë luftërave ballkanike, të ashtuquajturit Podgoriçanë, që jetojnë në këtë qytet.

Minoriteti serbo-malazez gjatë viteve të shekullit të kaluar ka qenë objekt padrejtësish nga ana e strukturave shtetërore të asaj kohe, masat institucionale represive të të cilave çuan në diskriminimin dhe përpjekjet për asimilimin e minoritetit. Kjo politikë represive asimiluese fillon me regjimin e mbretit Zog, i cili hoqi shkollat në gjuhën Serbe dhe vazhdoi me regjimin komunist, ku u zhduk kombësia serbo-malazeze, emrat dhe në veçanti mbiemrat karakteristikë që mbarojnë me prapashtesën “iq”, e drejta e shkollimit dhe e drejta e informimit në gjuhën amtare, e drejta e mbajtjes së kontakteve me shtetin mëmë, e drejta e besimit fetar etj.

Pas viteve 90', minoritetit serbo-malazez iu dha mundësia e lëvizjes së lirë me territorin e ish Jugosllavisë, gjë që çoi në zhvillimin e tregtisë dhe të mirëqënies të këtij minoriteti. Bujqësia dhe tregtia me Serbinë dhe Malin e Zi, janë burimet kryesore të të ardhurave për pjestarët e këtij minoriteti.

Zakonet lidhen ngushtë me festat e minoritetit, siç është ajo e Festës së Pagëzimit. Pjesëtarët e minoritetit festojnë festat fetare myslimane dhe ortodokse, Bajramin, Pashkët, Krishtlindjet etj sipas përkatësisë së tyre fetare. Rrallëherë ndodh që miqtë të ftohen, por kumbarët dhe të njohurit vizitojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke. Festat ortodokse festoheshin më përpara edhe për 7 ditë, ndërsa tani për 3 ditë. Prifti vjen zakonisht në çdo festë fetare, në prag të festës, dhe me të zotin e shtëpisë kryen ceremonitë dhe zakonisht, ndezin qirinjtë, ndajnë ëmbëlsirën e festës dhe me tamjan kalojnë nëpër shtëpi. Ngrihen shumë gota për shëndetin e të gjithëve. Por më të rëndësishmet janë dy: për të zotin e shtëpisë dhe për lavdinë e zotit dhe të shenjtorit.¹¹

Statistikat zyrtare të cilat gjenerohen nga Censusi i përgjithshëm i popullsisë dhe banesave të vitit 2011, flasin për 366 malazezë dhe 142 serbë. Organizatat e minoriteteve, përfshirë dhe ato të minoritetit serbo-malazez, bojkotuan Censusin për shkak të moskonsiderimit të kërkesave të tyre për përjashtimin eksplicit të deklarimit mbi pyetjen e përkatësisë etnike dhe fetare si kundravajtje administrative, pjesëmarrjen në grupet e regjistrimit, dhënien e kopjes së formularit të deklarimit për pjesën mbi etninë çdo personi të interesuar për të, etj.

Nga vlerësimet e organizatave të këtij minoriteti, pretendohet se në Shqipëri jetojnë aktualisht rreth 30 mijë vetë, me origjinë serbo-malazeze¹².

Gjuha ruhet në komunikimin në komunitet, por në mungesë të arsimit, brezat e rinj po e humbasin aftësinë për të komunikuar dhe ditur gjuhën amtare.

Aktualisht, “Ekziston një vakum në të dhënat për pjesëmarrjen e pakicës serbo-malazeze në jetën publike të Shqipërisë”.¹³

¹⁰ Shih <http://www.minoriteti.kombetar.serbo-malazez.com>

¹¹ Webiste: st.glovara.com/dip_upload/UV10002391_158085.pdf

¹² Termi minoritet serbo-malazeze nënkupton një grupim popullsie me karakteristika etnike identikisht të njëjta që jetojnë në Shqipëri.

¹³ Arqile Bërxioli, “Minoritetet në Shqipëri”, Tiranë, 2008.

Shoqatat të cilat merren me çështjet e minoritetit serbo-malazez janë: Shoqata e minoritetit serbo-malazez “Moraça-Rozafa”, Shoqata e minoritetit malazez “Duklja” dhe Shoqata ortodokse “Shën Jovan Vladimir” me qendër në Shkodër, si dhe Shoqata e serbëve të Shqipërisë “Jedinstvo”.

*** Minoriteti Vllah (Arumun)**

Vllehtë e mbajnë veten si pasardhësit e largët të banorëve romakë të provincës së Dakisë, që po ta shikojmë është Rumania e sotme, pasi kanë qënë shpërngulur nga pushtimet e gotëve të shek. III dhe IV pas Krishtit. Ata vazhduan një mënyrë jetese prej nomadësh dhe dora-dorës kapërcyen malet e Ballkanit, për të ardhur në vendbanimet e tanishme, pra edhe në Shqipërinë e sotme. Por ky është një nga mendimet mbi zhvendosjen e vllehëve, pasi po të shihet harta e vendndodhjeve të fiseve Dake në shek. I-VI pas Krishtit, kufijtë e Dakisë në jug të saj, nga perëndimi shkojnë deri në Lissus (Lezhë) në drejtim të Scupi, Serdica e deri në Tomis (Kostanca e sotme) në Detin e Zi. Në këto kushte shtegtimi i tyre mund të këtë ndodhur më përpara, rreth shek. I, deri në shek. II pas Krishtit, dhe kjo si rezultat i pushtimeve romake. Megjithatë kjo është një periudhë e errët në histori si për arumunët, po ashtu edhe për të gjithë popujt e tjere ballkanikë. Në këtë periudhë, nga viti 107 deri 271, kur sundimi romak në Daki ka qënë i pranishëm, perandori Aurelian, nën trysinë e gotëve, shpërnguli popullsinë e latinizuar nga të gjitha viset që kishte pushtuar mbi lumin e Danubit, pra nga Rumania e sotme dhe i sistemoi ata më poshtë, në jug të lumit Danub.

Mbi variantin historik të ardhjes së vllehëve në Shqipëri bashkë me pushtuesit romakë është shprehur dhe ka shkruar prof. Antonio Baldacci¹⁴ në librin e tij të vitit 1914, “I Romeni dell Albania”.

Ishte një kohë, ku i gjithë rajoni lindor i Tomorrit kishte arritur të bëhej një principatë e vogël arumune, e cila pati kompaktësim dhe lulëzim në tregti. Këtu ishte Voskopoja me 20.000 shtëpi dhe qendra të tjera rreth saj si Grabova, Llënga, Niça, etj me 7-12.000 shtëpi. Burileanu, pavarësisht nga vërtetësia e shifrave arriti në konkluzionin dhe vërtetoi traditën që ekzistonte në këto vise me arumunë.

Burileanu në veprën e tij shkruan: “Këta arumunë megjithëse të pakët jetojnë në bashkësi me shqiptarët dhe janë në raport miqësor ndërmjet tyre, kanë një jetë të vetën që bien në sy që në fillim e në brendësi: edhe se studiues të njohur e të pavarur n.q.se nuk njohin gjuhën habiten si kjo popullsi latine vesh një veshje të veçantë nga shqiptarët.”

Pas largimit të përhershëm nga rumunët e Dakisë, largim që mund të këtë ndodhur ndoshta midis shekujve VII dhe X, gjuha e tyre filloi të ndryshonte. Emrit rumen iu shtua një a, një fenomen i njohur në këtë dialekt, arriti të shqipëzohesh në Arumen dhe më pas u shëndërrua në Armën. Këtë emër përdorin në përgjithësi të gjithë arumunët. P.sh. arumunët që jetojnë në Shqipëri, të cilët thonë Romenë, Rëmën, ose Rumenë përdoret pa zanoren a. Emri Armën nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Por fjala arumun, vjen nga që në përgjithësi popullsia e Ballkanit ishte popullsi rume (nga vendi Rumeli, që quhesh Ballkani, pra rëmenjët që ishin latinë nuk ishin popullsi rume, por ishin popullsi a-rum (jo rume). Emërtimi i parë i kësaj popullsie është rëmenj-romenj

¹⁴ Antonio Baldacci, “I Romeni dell Albania” 1914, faqe 4.

pra nga Roma, pastaj vllëh që vjen nga Vllahia dhe e treta është arumun. Ndërsa emri “macedorëmën” vjen nga që shumica e rëmënëve jetonin në kohët e lashta në mbretërinë e Maqedonisë të Aleksandrit Madh.

Pikënisja rreth krijimit të gjuhës rumune ka qenë latinishtja popullore, gjuhë e folur nga popullsia në Danubin e Poshtëm në fillimin e mijëvjeçarit të parë (shek. III)¹⁵. Vërshimi i sllavëve dhe kolonizimi i tyre në Ballkan gjatë dy dekadave të para të shek. VII, përbën një çast udhëkryq lidhur me fatet e latinishtes danubiane. Këta larguan latinët në jug të Danubit, nga teroret e tyre, duke këputur unitetin e latinishtes në të dy brigjet e Danubit. Në vazhdim të shekujve, u shtuan uzurpatorë të tjerë: si pushtimi magjar, otoman, etj, të cilët prekën karakterin kompakt të latinitetit lindor dhe krijuan terrenin për krijimin e të katër dialekteve të gjuhës rumune: një në veri të Danubit, tre të tjerë në Ballkan.

Sot minoriteti vllah jeton në të gjithë vendin por ka ende disa qendra urbane në të cilat gjenden një komunitet i dallueshëm vllah. Kështu mund të përmendim qytete si Tirana, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Vlora, Selenica, Fieri, Gramshi, por edhe fshatra të njohura historikisht si Voskopoja, Grabova (Gramsh), “Andon Poçi” (Gjirokastër) etj.

Të dhënat e regjistruara për popullsinë vllahe në vend, nga censusi i viti 2011, kontestohen me forcë nga përfaqësues të shoqatave dhe partive të krijuara me fokus të veprimtarisë së tyre, mbrojtjen e minoritetit Vllah.¹⁶

***Minoriteti Rom**

Romët janë një grup etnik unik, të vendosur në territoret shqiptare prej kohësh dhe që ja kanë dal mbanë të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre. Sipas burimeve historike dhe linguistike, ata emigruan nga pjesët veriore të Indisë në valë të ndryshme të njëpasnjëshme qysh prej shekullit të IX deri në shekullin e XIV. Disa dokumente historike tregojnë se romët erdhën në Europën jugore nëpërmjet Persisë, Kaukazit, dhe Perandorisë Bizantine. Në disa prej burimeve, del që disa familje rome duhet të kenë mbërritur në Ballkan rreth shekullit të XIV (Kolsti, 1991) dhe janë vendosur në territorin e Shqipërisë rreth shekullit të XV (Koinova, 2000).

Edhe pse në Kongresin e Parë të Romëve më 1971 është përcaktuar termi “Rom”, sot në Shqipëri ata njihen me emra të ndryshëm.¹⁷ Në bazë të rrugës që romët kanë ndjekur për të hyrë në Shqipëri si dhe gjendjes së tyre socio-ekonomike, dialekteve gjuhësore, stilit të jetesës, profesionit, aftësive,

¹⁵ Stefan Fisher-Galaci, Dinu K. Xhiuresku, Ioan Aurel Pop “Historia e Rumanisë” faqe 57

¹⁶ Nga kontaktet me këta përfaqësues na janë referuar të dhëna sipas të cilave: Sipas prof. Kostandin Noe në gjuhën frënge në vitin 1913, kanë qenë 83.233 arumun/vllëh.

1. Në enciklopedisë italiane Treccani e vitit 1929 janë regjistruar 200.000 arumun/vllëh.
2. Në enciklopedinë e madhe Sovjetike viti 1950 ka rreth 300.000 arumun/vllëh.
3. Në enciklopedinë franceze Larus e vitit 1966 jep shifrën 350.000 arumun/vllëh
4. Regjistrimi i vitit 1955 në Shqipëri janë 4.200 arumun/vllëh.
5. Regjistrimi i vitit 1959 në Shqipëri janë 10.000 arumun/vllëh.
6. Në regjistrimin e vitit 2001 në Shqipëri janë 992 arumun/vllëh.
7. Atlasi Gjeografik i Shqipërisë ka shifrën 139.000 arumun/vllah.

Të dhënat e fundit Dhjetor 2012 janë arumun 0,3%...ose rreth 8.266 vetë.

¹⁷ Termat “gabel”, “arixhi”, “evgjit”, “jevg” janë përdorur historikisht për t’u referuar respektivisht romëve dhe egjiptianëve si komunitete inferiore dhe kjo është arsyeja pse sot, në të kuptuarit e përgjithshëm, këta emra konsiderohen si fyes për komunitetet në fjalë dhe, si rezultat, përdorimi i tyre duhet të shmanget (Taho 2002).

zakoneve, etj., janë organizuar në fise¹⁸ që, në Shqipëri janë të njohur si: *meçkar, çergar, arlinj, bamillë dhe kurtofë*.

Në Shqipëri nuk është realizuar asnjëherë ndonjë regjistrim zyrtar i numrit të popullsisë me përkatësi në minoritetin Rom, me përjashtim të vetëdeklarimit të vitit 2011, i cili nuk arriti të nxirrte rezultate të pakontestueshme. Qeveria shqiptare në strategjinë për përmirësimin e kushteve të minoritetit Rom, miratuar në vitin 2003, citon burime të ndryshme për të vlerësuar popullatën rome, mes 60 mijë dhe 120 mijë personash.¹⁹

Edhe pse romët tradicionalisht janë njohur si nomadë, duke filluar nga vitet 30', të shekullit XX, shumica e fiseve të tyre u kthyen gradualisht në gjysmë-nomadë, ose tërësisht sedentarë (Hasluck, 1938). Ky nomadizëm dhe lëvizja e tyre shumëshekullore ka patur funksion ekonomik, ka qenë pjesërisht strukturor dhe lidhet ngushtë me kulturën e tyre (Liegeois, 2009). Përfundimisht, ata u vendosën në vendbanime të qëndrueshme gjatë viteve 1960-1970.

Gjatë periudhës së tranzicionit post-socialist, si rezultat i kolapsit dhe mbylljes së ndërmarrjeve shtetërore dhe për shkak të karakterit e të aftësive të tyre, si dhe niveleve të ulëta të arsimimit, pa përjashtuar këtu paragjykimet dhe diskriminimin, Romët kanë kaluar nga një gjendje relativisht e mirë, në varfëri të skajshme. Për shkak të kushteve socio-ekonomike dhe qëndrimeve diskriminuese, romët u detyruan të bënin një jetë endacake për një kohë më të gjatë se sa etnitë e tjera, duke mos pasur kështu mundësinë të krijojnë një administratë shtetërore, e cila do të mund të kujdesej për dokumentimin e historisë së popullit rom.²⁰

Kjo ka qenë arsyeja që pjesë e historisë së romëve u shkruajt nga jo-romët, duke mos u bazuar në kërkimet historike, por më shumë në imazhin dhe perceptimet e tyre ndaj Romëve. Për shekuj me radhë historianët referuan njëri-tjetrin duke pasur gjithmonë të njëjtin perceptim ndaj romëve si një popull pa kulturë dhe endacakë, derisa në vitet e fundit disa kërkimtarë analizuan dhe hodhën poshtë hipotezat shekullore historike dhe ofruan shpjegime të reja mbi historinë e romëve, shpjegime të cilat konfirmuan tezat e hedhura disa dekada më parë nga gjuhëtarët. Gjithsesi, kjo situatë dëshmon për forcën e imazheve dhe stereotipeve në opinionin publik, deri në atë masë sa, këto perceptime kanë sunduar për shekuj me radhë edhe në histori. Ashtu si historia e romëve dhe imazhi i tyre ndërtohet dhe përdoret si nga shumica, po ashtu dhe nga popullsia Rome.²¹

- Komunitete të tjera:

***Komuniteti Boshnjak:** Komuniteti Boshnjak ka mbërritur në Shqipëri në vitin 1878. Boshnjakët apo, siç i ka mbetur emri nga turqishtja muhaxhir

¹⁸ Studim mbi prejardhjen e Romëve, Marsel Kurtiade.

¹⁹ Bazuar në burimet franceze, në vitin 1980 numëroheshin 62 mijë rom në Shqipëri. Në 1995, Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve e përcaktoj numrin e popullsisë rome në Shqipëri ndërmjet 90 deri në 100 mijë. Gjithashtu në 1995, Universiteti i Maryland bëri të ditur që ishin deri në 120 mijë romë që jetonin në Shqipëri.

²⁰ Pavarësisht prejardhjes nga India, shteti Indian nuk i ka njohur Romët si bashkëkombësit e vet.

²¹ Gjatë Luftës së Dytë Botërore, thuhet gjysmë milioni romë nga vende të ndryshme të Europës u ekzekutuan, ose u vranë në kampet naziste të përqendrimit (Ringold et al., 2003). Në Shqipëri, trajtimi i tyre ishte më i mirë se sa në vendet fqinje, ku përveç internimit në kampet naziste, Romëve iu duhej të përballeshin edhe me spastrim etnik.

(refugjatë), jetojnë në zonën fare pranë Shijakut, në fshatrat Koxhasë e Borakë. Tashmë ka kaluar më shumë se një shekull nga qëndrimi i tyre në vendin tonë, por nëse takohesh me boshnjakët, kupton se gjuha e shumë tradita të tjera nuk janë harruar prej tyre.

Nga regjistrimi i popullsisë që u bë nga censusi i vitit 2011, nuk rezulton të jetë dhënë një numër i popullsisë që jeton në Shqipëri dhe i përket etnisë boshnjake, megjithatë përfaqësues të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e këtij komuniteti deklarojnë se në të gjithë vendin jetojnë rreth 10.000 boshnjakë. Në këtë numër përfshihen individët me etni boshnjake që jetojnë në Tiranë, Durrës, si dhe qytete të tjera të Shqipërisë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre është vendosur në fshatin Borakë, i cili ndodhet afër qytetit të Shijakut.

Boshnjakët fillimisht mbanin emrat e familjarëve të tyre origjinale, pra i kishin mbiemrat mysliman, por duke i'u referuar disa të dhënave për boshnjakët e vendosur në fshatrat e Shijakut, nga regjistrimi i vitit 1918, emrat e tyre tashmë nuk ishin më të ruajtur në gjuhën sllave, por i ishin përshtatur gjuhës shqipe. Të pakta ishin rastet ku mbiemri ruhej në origjinalin e tij sllav dhe kur në listat e regjistrimit, mund të shikohej mbiemri i vjetër origjinal.

Për të mbrojtur të drejtat e tyre, komuniteti boshnjak ka krijuar Shoqatën “Zambak”, e cila është themeluar me 28 tetor 1995. Shoqata “Zambak” është një shoqatë, nismë e një grupi që synon nxitjen dhe zhvillimin kulturor midis dy popujve, boshnjakë dhe shqiptarë. Ndërhurja e kulturave shqiptare dhe boshnjake, dhe zhvillimi i bashkëpunimit të mëtejshëm kulturor dhe social, është një ndër parimet kryesore të Shoqatës.

Me krijimin e saj, anëtarët e Shoqatës “Zambak” kanë synuar konsulencë për njëri-tjetrin në nevojat profesionale dhe problemet sociale, apo ekonomike. Me një grup anëtarësh dinamik dhe falë mbështetjes së vazhdueshme të simpatizantëve, shoqata “Zambak” ka për qëllim nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të Komunitetit Boshnjak në Shqipëri, me qëllim rritjen e nivelit social, ekonomik, kulturor dhe arsimor, si dhe krijimin e lidhjeve midis popujve, kulturave Shqipëtare dhe asaj Boshnjak dhe më gjerë.

***Komuniteti Egjiptian:** Një ndër problemet kryesore ka qënë emërtimi i këtij komuniteti në Ballkan, me prejardhje nga Egjipti, megjithëse egjiptianët e sotëm që jetojnë në këtë gadishull nuk ka lidhje të mëdha me egjiptianët që sot jetojnë në Republikën Arabe, të Egjiptit.

Migrimi i egjiptianëve të Ballkanit ka ndodhur para shekullit të VII.e.s, kur feja islame depërtoi në Egjipt. Ky komunitet ka veçanti dhe diferenca etnografike dhe etno kulturore nga komunitete të tjera në Ballkan, ndaj edhe për këto arsye, sot përdoret termi “Egjiptianët e Ballkanit”.

Ky komunitet është shpërndarë gati në të gjithë Ballkanin, duke jetuar sot në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mat të Zi, Greqi, Bullgari dhe Serbi.

Vendbanimet kryesore aktualisht të këtij komuniteti në Republikën e Shqipërisë, janë qytetet Tiranë, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe në disa qytete të tjera të vogla, pa përjashtuar këtu edhe fshatra të caktuara.

Aktualisht komuniteti egjiptian sot në Shqipëri nuk ka një gjuhë të vetën sikurse, ndodh me minoritetin Rom. Kudo ku ky komunitet është vendosur në të gjithë ballkanin, flet gjuhën e vendit pritës.

Zanati i farkëtarisë dhe përpunimit të metalit ka qënë profesioni tradicional i pjesës më të madhe të popullsisë egjiptiane ballkanase, por kjo nuk

përfashton edhe zanate të tjera. Ky komunitet dallohet edhe veçanti në fushën e muzikës dhe në tradita që shfaqen në gëzime familjare, të cilat e dallojnë nga komunitet e tjera në vend.

***Komuniteti Goran:** Ky komunitet jeton kryesisht në një krahinë etnografike të njohur me emrin Gorë, në lindje të Kukësit. Megjithë shmangien nga rrugët kryesore, Gora ka pozitë gjeografike që lejon lidhje me Lumën, me Tetovën, me Dibrën dhe me Kosovën. Gjurmë të popullimit të kësaj krahine gjenden që nga lashtësia, ndërkohë që banimi i një pjesë të fshatrave të Gorës dëshmohej që në gjysmën e dytë të shekullit të XII, kohë e sundimit të perandorit bizantin Mihail Komnenit. Që nga shekulli i XIV, ku e gjejmë të përmendur si ëmer së pari, e deri më sot, kjo krahinë del me emrin e pandryshuar Gorë.

Aktualisht krahina ka një popullsi të përzier sllave dhe shqiptare. Prej fqinjëve banorët e zonës emërtohen “goranë”, “torbeshë”, “shkije”, dhe “poturë”, kurse vet banorët vetëquhen “gorani” dhe “nashinci”.

Sa i takon prejardhjes sllave së kësaj popullsie, mendimi dominues lidhet me disfatën e lëvizjes heretike të bogomilëve (Bullgaria jugperëndimore, shekulli XII), e cila u përcoll me përndjekje popullatash të stigmatizuara nga kisha e kohës.

Popullsia kompakte sllave e Gorës së Kukësit, jeton në fshatrat Borje, Cernalevë, Kosharisht, Orgjost, Oreshek, Oçikël, Pakisht, Shishtavec dhe Zapod. Popullsia sllave e kësaj krahine gjendet edhe në qytetet Kukës, Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Lushnjë, Patos, Korçë, Kavajë, Shkodër etj.

Kjo zonë ruan një kulturë shpirtërore me natyrë të qartë sllave (gjuha, folklori, mendësia, ornamentika) dhe paraqet nga ana tjetër afërsi me kulturën materiale dhe folklorin koreografik të shqiptarëve. Gjuha e përdorur sot, sipas studimeve të disa autorëve, cilësohet si dialekt i gjuhës së përdorur në Maqedoninë, jugperëndimore.

6. Problematikat e konstatuara nga inspektimet e Avokatit të Popullit, në vendbanimet kryesore të minoriteteve në vend.

Bazuar në eksperiencën e akumuluar nga puna e përditëshme e institucionit, si dhe veçanërisht në konstatimin dhe perceptimin që është marrë nga vet përfaqësuesit e shoqërisë civile që mbron të drejtat e minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend, në këtë pjesë të raportit do të flitet për disa problematika të konstatuara në çështje që, lidhen kryesisht me njohjen dhe respektimin e të drejtave të afirmuara për minoritetet në Konventën Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.²²

Sipas kësaj skeme, problemet e evidentuara evidentojnë zbatimin dhe respektimin e të drejtave që lidhen me mosdiskriminimin; ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore; pjesëmarrja në sistemin arsimor shtetëror; shtypi i shkruar dhe media audiovizive lokale në gjuhën minoritare; ushtrimi i lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe

²² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, dhe legjislacioni në fuqi ku mund të përmendim Kodin e Punës, Kodin Penal, Kodin Zgjedhor e një sërë ligjesh të tjera apo edhe akte nënligjore, janë përafëruar kënaqshëm me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.

besimit fetar; përdorimi i lirshëm i gjuhës minoritare apo komunitare; kontaktet e lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera; specifikisht, të drejta të fëmijëve që lidhen me aksesin në arsimin shtetëror, tekstet shkollore dhe përmbajtjen e tyre, sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit, dhe diskriminimit të mundshëm ndaj tyre në procesin mësimor.

Nga të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të formuluar për këtë qëllim dhe kontakteve me banorë të zonave ku ka shumicë minoritare, apo të komuniteteve të tjera, na rezulton se:

Minoriteti Grek:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, konfirmohet fakti se, gjendja aktuale është e përmirësuar në këtë drejtim, por në raste të caktuara individuale shfaqen elementë diskriminimi nga ana e popullsisë mazhoritare, ndaj popullsisë minoritare.
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, përgjigjet e dhëna konstatojnë mangësi të dukshme dhe një njohje jo të mjaftueshme.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore. Nga përgjigjet e dhëna pohohet se, janë marrë masa përkatëse për këtë çështje, megjithatë ato janë të pamjaftueshme nga ana e shtetit.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka probleme.
- Lidhur me ekzistencën e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare. Pohohet se në kuadër të shtypit të shkruar ka mungesa që vijnë kryesisht për shkak të mosfinancimit të tij nga ana e shtetit dhe aftësive të pakta që realisht ekzistojnë, për financimin e tij nga ana e individëve privatë. Ka emisione javore që transmetohen në gjuhën greke në stacione private rajonale televizive, si dhe një minutazh të caktuar që transmetohet po në këtë gjuhë në Radio Gjirokastra (RTSH).
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa dhe se këto liri përgjithësisht ushtrohen lirisht nga ana e pjestarëve të minoritetit.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm.
- Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, përgjigjet konstatojnë ushtrim të lirshëm të këtyre të drejtave.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se, në shkollat nëntëvjeçare shtetërore zhvillohet proces

mësimdhënie edhe në gjuhën minoritare. Ndërkohë pohohet se, në tekstet shkollore të ofruara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk ka përfshirje të njohurive të sipërcituara.

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë dhe janë siguruar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Tekstet e shkollës nëntëvjeçare sigurohen falas, ndërsa në shkollën e mesme nuk ka libra në gjuhën amtare.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se ekzistojnë shkolla me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Minoriteti Maqedonas:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, pohohet fakti se, ka elementë të jetës së përditëshme të cilat japin perceptimin tek pjestarët e minoritetit të një pabarazie që ekziston ndërmjet gjendjes aktuale të minoritetit maqedonas dhe pjesës tjetër të popullsisë mazhoritare (përfaqësimi në administratën qendrore dhe vendore, shkollimi në gjuhën amtare jo vetëm në shkollat publike të zonës së Prespës etj).
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, përgjigjet e dhëna konfirmojnë një njohje të kënaqshme të tyre.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, mendimi i shprehur është se nuk janë marrë masat e duhura dhe se pavarësisht se në vitin 2010 është krijuar Sektori i Kulturës së Minoriteteve dhe Diasporës pranë Ministrisë së Kulturës, ky sektor në këto vite nuk ka mbështetur projekte për minoritetin maqedonas.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka vështirësi. Sa i takon shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive në gjuhën minoritare, pohohet se periodikisht në dy-tre muaj del në 1000 kopje gazeta në gjuhën maqedonase "PRESPA", organi i Unionit të Maqedonasve të Shqipërisë, si dhe gazeta on-line "Makedonium", organ i shoqatës Maqedonase "SONCE", e cila del në dy gjuhë, maqedonisht dhe shqip. Këto gazeta cilësohet se, nuk kanë mbështetje nga ana e ndonjë institucioni shqiptar.
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm. Pohohet se, në jetën private përdoret lirshëm gjuha e minoritetit maqedonas. Në zonat e Prespës, Gorës dhe Gollobërdës, gjuha që përdoret në jetën e përditëshme private dhe publike është gjuha maqedonase. Po kështu, pohohet se fëmijët në këto zona deri në moshën 7 vjeç nuk e flasin gjuhën shqipe dhe atë fillojnë ta mësojnë në shkolla. Nuk janë ndeshur probleme në këtë drejtim.

- Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, konstatohet se, gjërat kanë ardhur në përmirësim, pavarësisht problemeve të konstatuara.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tesktet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se në zonën e Prespës, ku fëmijët e minoritetit maqedonas kanë të drejtë të mësojnë gjuhën maqedonase, vitet e fundit është futur lënda "Historia e Maqedonisë".
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se në zonën e Prespës, komuna e Pustecit, mungojnë tekste shkollore për zhvillimin e lëndëve në gjuhën maqedonase. Në shkollat e kësaj zone, fëmijët e minoritetit maqedonas kanë të drejtë të mësojnë në gjuhën maqedonase dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22. 08. 1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve", gjithë mësimdhënia në këto zone duhet të jete 60% në gjuhën maqedonase dhe 40% në gjuhën shqipe. Por asnjëherë nuk është zbatuar ky vendim për shkak të mungesës së teksteve për lëndet që duhet të jenë në gjuhën maqedonase. Në zonën e Prespës fëmijët disponojnë tekste në gjuhën maqedonase dhe këto libra i miraton Ministria e Arsimit dhe Sportit.²³ Tekstet për fëmijët minoritare janë falas.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se në zonën e Prespës, komuna e Pustecit të gjithë shkollat fillore dhe dy shkollat nëntëvjecare janë me sistem dy gjuhësh dhe sipas VKM nr.396, datë 22.08.1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve", gjithë mësimdhënia në këtë zonë duhet të jetë 60% në gjuhën maqedonase dhe 40% në gjuhën shqipe dhe se nuk ka diskriminim.

Minoriteti Serbo-Malazez:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, konfirmohet fakti se, ndihet një perceptim pjesërisht diskriminues, veçanërisht në disa fusha si në arsimim dhe në sport.
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, përgjigjet e dhëna konfirmojnë njohje të kënaqshme të tyre.

²³ Sipas të dhënave të marra nga ana e shoqatës që mbron të drejtat e minoritetit maqedonas "Sonce", nga 55 tekste shkollore që Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet ti botojë në gjuhën maqedonase, vetëm 22 tekste janë botuar, 8 tekste janë përgatitur dhe nuk janë botuar, kurse 33 tekste shkollore as janë përgatitur dhe as janë botuar.

- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, mendimi i shprehur është se nuk janë marrë masat e duhura dhe se, vitet e shkuara ka patur probleme, por shpresohet që gjendja të përmirësohet aktualisht.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se ka nuk ka vështirësi për aksesin në arsimim dhe se, nuk ka shtyp të shkruar dhe media audiovizive në gjuhën minoritare.
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se në procesin formal nuk ka pengesa, por ato janë shfaqur në raste të caktuara individuale në ushtrimin e lirshëm të tyre.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm, pavarësisht incidenteve të izoluara që mund të ndodhin.
- Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, konstatohet se, ka kufizime dhe se vitet e fundit gjërat kanë ardhur në përmirësim.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se nuk ka elementë të tillë në tekstet shkollore, (por së fundmi kjo gjë është premtuar se do të përmbushet nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme), për zonat ku ka minoritet serbo-malazez.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë dhe janë siguruar nga ana e shoqërisë civile, falas për fëmijët e minoritetit, por nuk përdoren në procesin mësimor shtetëror por në kurset që shoqatat përkatëse zhvillojnë për mësimin e gjuhës amtare. Pohohet se nuk ka shkolla shtetërore me sistem dy gjuhësh në zonën e Vrakës, Shkodër.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh, të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, pohohet se nuk ka shkolla shtetërore me sistem dy gjuhësh në zonën e Vrakës, Shkodër (dhe kjo gjë vlen edhe për zonën e Libofshës, Fier), dhe se përgjithësisht nuk ka diskriminim.

Minoriteti Rom:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, konfirmohet fakti se, perceptimi i përgjithshëm është se ka barazi, por jeta e përditëshme shfaq raste përjashtimi dhe diskriminimi nga aksesin në të drejta të barabarta.

- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, konstatohet se ekzistojnë këto njohuri në dokumentat më kryesore.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, konstatohet se nga ana e shtetit janë marrë masa, por ato konsiderohen ende të pamjaftueshme.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se ka probleme që lidhen me anën subjektive të çështjes, si braktisja e shkollës apo mosfrekuentimi, si dhe me krijimin e një ambienti jo paragjykues dhe pranues për fëmijët Romë në shkollë.
- Lidhur me ekzistencën e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare, rezulton se transmetohet një emision në gjuhën rome nga ana e RTSH-së Korçë, me minutazh të caktuar, por mbetet kërkesë shtrirja e emisioneve të tilla edhe në zona të tjera të banuara nga Romët.
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa dhe se këto liri ushtrohen lirisht nga ana e pjestarëve të minoritetit.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm.
- Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, përgjigja është se nuk ka pengesa.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konfirmohet se ka disa përpjekje të cilat konsiderohen jo cilësore dhe jo adekuate. Ende nuk mund të mësohet në sistemin arsimor shtetëror në gjuhën Rome.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato nuk ekzistojnë.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Efektivisht, problemet që sot shqetësojnë këtë minoritet janë trajtuar gjerësisht në raportin e veçantë mbi gjendjen e minoritetit Rom në Shqipëri, dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë në fund të vitit 2013, të cilin po ia bashkëngjisim këtij raporti.

Minoriteti Vllah:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, pohohet fakti se, ka elementë të jetës së përditëshme të cilat japin perceptimin e një pabarazie që ekziston ndërmjet gjendjes aktuale të minoritetit vllah dhe pjesës tjetër të popullsisë mazhoritare (përfaqësimi në administratën shtetërore, apo në përfaqësimin politik).
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, përgjigjet e dhëna konfirmojnë një njohje të pakët të tyre.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, mendimi i shprehur është se nuk janë marrë masat e duhura. Shteti sipas pohimeve të dhëna, nuk ka marrë masat e nevojshme pozitive që ndikojnë drejtpërdrejtë në këtë aspekt, pasi më shumë kanë qënë angazhime private të vet pjestarëve të minoritetit, si p.sh në mësimin e gjuhës minoritare.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka vështirësi. Sa i takon shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive në gjuhën minoritare, pohohet se ai minoriteti vllah nxjerr privatisht një gazetë, gazetën "Fratia" dhe revistën "Arumunët Durrës".
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa dhe se këto liri dhe të drejta ushtrohen lirisht.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm dhe se nuk ka probleme.
- Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, konstatohet se, nuk ka probleme.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se nuk ka elementë të tillë të përfshirë në tekstet shkollore. Gjithashtu, pohohet se nuk mund të mësohet aktualisht në sistemin arsimor shtetëror në gjuhën vllahe.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se nuk ka të tillë të ofruar nga ana e shtetit. Janë organizuar vetëm disa kurse verore të gjuhës privatisht.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla të tilla dhe se, nuk ka diskriminim.

- **Komunitetet e tjera:**

- Komuniteti Boshnjak (Borakë):**

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, konfirmohet fakti se, nuk vërehen element diskriminimi krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë.
 - Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, konstatohet një dijeni e mirë mbi aktet kryesore.
 - Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, përgjigjet e dhëna konfirmojnë marrjen e masave të kënaqshme.
 - Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka probleme.
 - Lidhur me ekzistencën e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare, konstatohet se nuk ka shtyp të shkruar në gjuhën e komunitetit, por nëpërmjet sistemit kabllor është mundësuar privatisht ndjekja e një kanali televiziv "Hajat Tv".
 - Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa dhe se këto liri ushtrohen lirisht nga ana e pjestarëve të komunitetit.
 - Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha komunitare përdoret lirshëm dhe pa pengesa.
 - Lidhur me demonstrimin e lirshëm në publik të gjuhës minoritare, emrit, mbiemrit, shenjave, mbishkrimeve, apo informacioneve të tjera të një natyre personale, konstatohet se ekziston dhe ushtrohet kjo liri, pa pengesa nga ana e shtetit.
 - Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
 - Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të komunitetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën komunitare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se nuk ka një përfshirje të tillë. Por evidentohet fakti se, fëmijët e këtij komuniteti mund të mësojnë gjuhën boshnjake në shkollë, në shkollën nëntë vjeçare "Adem Sabli", Shijak.
 - Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
 - Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë në shkollën nëntë vjeçare "Adem Sabli", Shijak dhe se, janë siguruar nga ana e Ministrisë së Arsimit, në Bosnjë, falas.
 - Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se ekziston një shkollë me sistem dy gjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

- Komuniteti Egjiptian:**

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, në pyetësorët e plotësuar konfirmohet fakti se, formalisht ka barazi, por jeta e përditëshme shfaq raste përjashtimi dhe diskriminimi nga aksesimi në të drejta të barabarta.
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, konstatohet se ekzistojnë këto njohuri mbi aktet kryesore.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimit të kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, konstatohet se nga ana e shtetit nuk janë marrë plotësisht masat e nevojshme dhe kjo lidhet me mosnjohjen me statusin e minoritetit.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se në përgjithësi nuk ka problem dhe se nuk ka shtyp të shkruar dhe media audiovizive lokale në gjuhën komunitare, pasi nuk ekziston një gjuhë e tillë për komunitetin Egjiptian.
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk ka pengesa dhe se këto liri ushtrohen lirisht nga ana e pjestarëve të komunitetit.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë të vazhdueshme dhe shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tesktet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, konfirmohet se në asnjë tekst shkollor nuk ka përfshirje të këtyre njohurive.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të komunitetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa, deri në shkollën e lartë.
- Sa i takon ekzistencës së diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se, në raste të veçanta shfaqet diskriminim nga mësues të cilësuar si të “papërgjegjshëm”.

Komuniteti Goran:

- Lidhur me çështjet e diskriminimit, konfirmohet fakti se, perceptimi i përgjithshëm është se ka pabarazi në jetën e përditëshme.
- Sa i takon njohjes së akteve me kryesore ligjore, që afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat e minoritetit, konstatohet se ekzistojnë këto njohuri në dokumentat më kryesore.
- Lidhur me masat që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimit të kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore, pohohet se nga ana e shtetit nuk janë marrë këto masa të nevojshme.
- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka problem.
- Lidhur me ekzistencën e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare, rezulton se nuk ekziston shtypi dhe media audiovizive në gjuhën e këtij komuniteti.
- Lidhur me ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar, nga përgjigjet e dhëna rezulton se nuk

ka pengesa dhe se këto liri ushtrohen lirisht nga ana e pjestarëve të komunitetit.

- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës komunitare, konstatohet se gjuha përdoret lirshëm në jetën e përditëshme të komunitetit, por jo në jetën publike.
- Lidhur me mbajtjen e kontakteve të lira me personat jashtë kufijve të së njëjtës kombësi me minoritarët, apo të kombësive të tjera, pohohet se lidhjet janë shumë të mira.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konfirmohet se nuk ka njohuri të tilla në tekstet shkollore.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të komunitetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato nuk ekzistojnë.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla me sistem dy gjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Krahas kësaj panorame të përgjithshme të marrë në takimet që janë zhvilluar me komunitetet respektive gjatë inspektimeve të zhvilluara për përgatitjen e këtij raporti, janë prezantuar edhe disa problematika të tjera që kanë të bëjnë me:

- Mungesën e një procesi të regjistrimit të popullsisë (censusi), të pakontestuar dhe të gjithëpranuar edhe nga minoritetet dhe komunitetet e tjera, i cili do të jepte shifrat reale të popullsisë minoritare, apo edhe të komuniteteve të tjera.
- Integrimin real të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditëshme, veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qendror.
- Mungesën e një konsultimi dhe konsiderimi real të kërkesave të përfaqësuesve të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera, gjatë zhvillimit të procesit, për reformën territoriale në vend.
- Krijimin e kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe komunitetet e tjera, përfshirë këtu edhe financimin me një buxhet më adekuat për njësitë e qeverisjes vendore, ku ka komunitete minoritare dhe komunitete të tjera në një masë dalluese me pjesën tjetër të popullsisë mazhoritare.

7. Të drejtat e fëmijëve në minoritete dhe komunitete të tjera

Një nga angazhimet gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërive dhe mekanizmave të tyre qeverisëse, sot është investimi dhe puna për një botë të denjë për fëmijët, ku ata e nisin jetën në mënyrën më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata, kane mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale

ne nje mjedis te shendetshem dhe inkurajues. Pikërisht ky mjedis, duhet të shërbejë si nxitës për zhvillimin fizik, psikologjik, shpirtëror, shoqëror, emocional dhe kulturor të fëmijëve, si nje çështje qe tashme eshte prioritet global. Shoqëria shqiptare, është bere pjese e ketij angazhimi global, ne realitetin e ndryshëm dhe të pabarabartë në rajone të ndryshme, ku një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojne ne kushte te renda dhe shpesh pa mbështetjen e prindërve të tyre. Realiteti shqiptar prezanton një shoqëri ku problemet sociale janë të mprehta, ku mireqenia dhe mjedisi ku jetojme jane çështje te prekura perdite, por që çdo ditë nxjerrin nevojën e nderhyrjes shumeplanesh shtet-shoqeri, ku shtresa dhe kategori te ndryshme sociale vulnerable, kerkojne me shume barazi dhe integrim me pjesen tjeter te shoqerise.

Varferia e dukshme, mbetet një pengese e madhe për perballimin e nevojave, mbrojtjen dhe nxitjen e te drejtave te fëmijëve, pasi fëmijet jane shume te prekshem ndaj varferise, e cila godet rrënjët e mundësive per zhvillim, trupat e tyre ende ne rritje dhe mendjet e tyre të brishta. Por edhe diskriminimi është një realitet nga i cili nuk mund të shpëtojnë as fëmijët, pavarësisht përkatësisë së tyre.

Në këto kushte, respektimi dhe vlerësimi i dinjitetit të fëmijëve në përgjithësi, lidhet pazgjidhshmërisht me afirmimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në një shoqëri që përditë aspirojnë vendosjen dhe konsolidimin e vlerave demokratike. Udhërrëfyes të pazëvendësueshëm në këtë përpjekje jetike globale për shoqëritë demokratike, mbeten parimet e interesit më të lartë të fëmijës, të mosdiskriminimit, të pjesëmarrjes, mbijetesës dhe zhvillimit.

Në këtë kuadër, në raport kemi vlerësuar se një pjesë modeste të tij duhet të zërë edhe trajtimi i disa të drejtave të fëmijëve të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera ne vend. Është e kuptueshme që ky nuk paraqet një trajtim shterues të të gjithë të drejtave të tyre, por mbulon disa nga ato të drejta që fëmijët në minoritete dhe komunitete të tjera duhet të gëzojnë specifikisht, për shkak të origjinës së tyre dhe përkatësisë së ndryshme në elementët që trajtojnë diversitetin kulturor dhe gjuhësor nga pjesa tjetër e popullsisë mazhoritare jo adulte, në Shqipëri.

Nga të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të formuluar për këtë qëllim dhe kontakteve me banorë të zonave ku ka shumicë minoritare, apo të komuniteteve të tjera, na rezulton se:

Minoriteti Grek:

- Lidhur me pjesëmarrjen në sistemin arsimor shtetëror, rezulton se nuk ka probleme. Ky është një element shumë i rëndësishëm i procesit të edukimit të fëmijëve të minoritetit, i cili lidhet me të drejtën për arsimim.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm. Ky është një nga elementët që ndikon në formimin e identitetit personal tek fëmija, sipas përkatësisë specifike të prejardhjes së tij.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror,

konstatohet se në shkollat nëntëvjeçare zhvillohet proces mësimdhënie edhe në gjuhën minoritare.

- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë dhe janë siguruar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se ekzistojnë shkolla me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Minoriteti Maqedonas:

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm. Pohohet se, në jetën private përdoret lirshëm gjuha e minoritetit maqedonas. Po kështu, pohohet se fëmijët në zonat e Prespës, Gorës dhe Gollobërdës, deri në moshën 7 vjeç nuk e flasin gjuhën shqipe dhe atë fillojnë ta mësojnë atë në shkolla.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se në zonën e Prespës, ku fëmijët e minoritetit maqedonas kanë të drejtë të mësojnë gjuhën maqedonase, vitet e fundit është futur lënda "Historia e Maqedonisë". Në zonën e Prespës fëmijët disponojnë tekste në gjuhën maqedonase dhe këto libra i miraton Ministria e Arsimit dhe Sportit. Nga 55 tekste shkollore që Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet ti botojë në gjuhën maqedonase, vetëm 22 tekste janë botuar, 8 tekste janë përgatitur dhe nuk janë botuar, kurse 33 tekste shkollore, as janë përgatitur dhe as janë botuar. Tekstet për fëmijët minoritare janë falas.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se në zonën e Prespës, komuna e Pustecit të gjithë shkollat fillore dhe dy shkollat nëntëvjeçare janë me sistem dy gjuhësh dhe se nuk ka diskriminim.

Minoriteti Serbo-Malazez:

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa, deri në shkollën e lartë.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm, pavarësisht incidenteve të izoluara që mund të ndodhin.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se në informacioni e marrë pohohet se nuk ka elementë të tillë në tekstet shkollore, por së fundmi kjo gjë është premtuar se do të përmbushet nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme), për zonat ku ka minoritet serbo-malazez.

- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë dhe janë siguruar nga ana e shoqërisë civile, falas për fëmijët e minoritetit.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se ekzistojnë shkolla me sistem dygjuhësh në zonën e Vrakës, Shkodër, dhe se përgjithësisht nuk ka diskriminim.

Minoriteti Rom:

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa. Ka probleme që lidhen me anën subjektive të çështjes, si braktisja e shkollës, apo mosfrekuentimi nga ana e fëmijëve Romë, si dhe me krijimin e një ambienti jo paragjykues dhe pranues për fëmijët Romë, në shkollë.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konfirmohet se ka disa përpjekje të cilat konsiderohen jo cilësore dhe joadekuate. Ende nuk mund të mësohet në sistemin arsimor shtetëror në gjuhën Rome.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato nuk ekzistojnë.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Minoriteti Vllah

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha minoritare përdoret lirshëm dhe se nuk ka probleme.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se nuk ka elementë të tillë të përfshirë në tekstet shkollore. Gjithashtu, pohohet se nuk mund të mësohet aktualisht në sistemin arsimor shtetëror në gjuhën vllahe.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se nuk ka të tillë të ofruar nga ana e shtetit.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla të tilla dhe se nuk ka diskriminim.

• Komunitetet e tjera:

Komuniteti Boshnjak (Borakë):

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të minoritetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës minoritare, konstatohet se gjuha komunitare përdoret lirshëm dhe pa pengesa.
- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të komunitetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën komunitare në sistemin arsimor shtetëror, konstatohet se nuk ka një përfshirje të tillë. Por evidentohet fakti se, fëmijët e këtij komuniteti mund të mësojnë gjuhën boshnjake në shkollë, vetëm në shkollën nëntë vjeçare “Adem Sabli”, Shijak.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato ekzistojnë në shkollën nëntë vjeçare “Adem Sabli”, Shijak dhe se, janë siguruar nga ana e Ministrisë së Arsimit, në Bosnjë, falas.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se ekziston një shkollë me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Komuniteti Egjiptian:

- Lidhur me përfshirjen në testet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, konfirmohet se në asnjë tekst shkollor nuk ka përshkrim të këtyre njohurive.
- Lidhur me aksesin e fëmijëve të komunitetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Sa i takon ekzistencës së diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se, në raste të veçanta shfaqet diskriminim nga mësues të cilësuar si të “papërgjegjshëm”.

Komuniteti Goran:

- Lidhur me aksesin e fëmijëve të komunitetit në sistemin e arsimit shtetëror, përgjigjet e dhëna konstatojnë ushtrim të pakufizuar të së drejtës së arsimit dhe pa pengesa.
- Lidhur me përdorimin e lirshëm të gjuhës komunitare, konstatohet se gjuha përdoret lirshëm në jetën e përditëshme të komunitetit, por jo në jetën publike.
- Lidhur me përfshirjen në tekstet shkollore të njohurive për kulturën, historinë, gjuhën dhe besimin fetar të minoritetit, si dhe mundësinë për të mësuar në gjuhën minoritare në sistemin arsimor shtetëror, konfirmohet se nuk ka njohuri të tilla në tekstet shkollore.
- Lidhur me tekstet shkollore në gjuhën amtare, përgjigjet janë se ato nuk ekzistojnë.
- Sa i takon ekzistencës së sistemit të mundshëm dy gjuhësh të arsimit shtetëror dhe diskriminimit të mundshëm në procesin mësimor, konstatohet se nuk ka shkolla me sistem dygjuhësh dhe se, nuk ka diskriminim.

Një ekspozitë më e gjerë e problematikave të respektimit të të drejtave të fëmijëve, gjendet në raportin e veçantë “Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të drejtat e fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar”, por ne do të veçojmë problematikën e fëmijëve Romë, të cilët shfrytëzohen për punë në rrugë, duke lypur apo duke bërë punë të vogla, ndërkohë që ata kanë qënë në rrezikun më të lartë për trafikim.

8. Karta Europiane e Gjuhëve Krahinore, ose Minoritare.

Shumë shtete europiane kanë në territorin e tyre grupe autoktone të vendosura në bazë krahinash që flasin një gjuhë të ndryshme, nga gjuha e shumicës së popullsisë. Kjo ka ardhur si pasojë e proceseve historike, sipas të cilave formimi i shteteve nuk ka ndodhur mbi bazën e linjave të qarta të lidhura me gjuhën, dhe se komunitetet e vogla janë gllabëruar nga komunitetet e mëdha.

Pavarësisht se si ka qënë situata në të shkuarën, në ditët e sotme kërcënimet me të cilat hasen këto gjuhë krahinore ose pakicash, shpesh shkaktohen të paktën po aq nga pashmangshmëria e ndikimit standardizues të civilizimit modern, veçanërisht të masmedias, sa edhe nga mjedisi jo miqësor, ose një politike asimiliuese.

Është e vërtetë se Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 14 parashikon parimin e mosdiskriminimit, duke parashikuar në veçanti aspektin e gëzimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa, duke përjashtuar çdo diskriminim të shkaktuar nga gjuha ose lidhja me një pakicë kombëtare.

Megjithëse shumë e rëndësishme, Konventa krijon vetëm një të drejtë për individët për të mos qënë objekt diskriminimi, por nuk krijon një sistem mbrojtjeje pozitive për gjuhët e pakicave dhe komuniteteve që i përdorin këto gjuhë, siç është theksuar nga Asambleja Konsultative që në vitin 1957, në Rezolutën nr.136.

Në vitin 1961, në Rekomandimin 285, Asambleja Parlamentare bëri thirrje për hartimin e një mase mbrojtëse për të plotësuar Konventën Europiane në mënyrë që të sigurohen të drejtat e pakicave për të gëzuar kulturën e tyre, për të hapur shkollat e tyre, e kështu me radhë.

Më pas në vitin 1981, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin 928, për problemet arsimore dhe kulturore dhe dialektet në Europë dhe në të njëjtin vit Parlamenti European, miratoi një rezolutë për të njëjtat çështje.

E paraprirë nga këto zhvillime, hartimi i Kartës u konkretizua në Rezolutën nr.192 (1988), të Konferencës së Përhershme, ku edhe u propozua teksti i Kartës, e cila u projektua të kishte statusin e një konvente.

Karta Europiane e Gjuhëve Krahinore ose Minoritare, u miratua si Konventë nga Komiteti i Ministrave në takimin e 478 të Zëvendës Ministrave në 25 Qershor 1992 dhe u hap për nënshkrim më 5 Nëntor 1992, në Strasburg. Siç bëhet e qartë edhe në Preambulën e saj, qëllimi kryesor i Kartës është aspekti kulturor. Qëllimi i saj është mbrojtja dhe nxitja e gjuhëve krahinore dhe të pakicave si një aspekt i kërcënuar i trashëgimisë kulturore të Europës.

Karta parashikon mbrojtjen dhe zhvillimin e gjuhëve krahinore ose të pakicave, jo të pakicave gjuhësore.

Ajo nuk përcakton të drejta individuale, ose kolektive për folësit e gjuhëve krahinore, ose të pakicave. Gjithashtu, duhet theksuar se, Karta nuk trajton situatën e gjuhëve të reja dhe shpesh jo europiane, të cilat mund të kenë dalë në shtetet nënshkruese si rezultat i rrjedhave migruese të kohëve të fundit, të cilat shpesh shkaktohen nga motive ekonomike.

Diversiteti gjuhësor është një ndër elementët më të vyer të trashëgimisë kulturore europiane. Identiteti kulturor i Europës nuk mund të ndërtohet mbi bazën e standardizimit gjuhësor.

Përkundrazi, mbrojtja dhe forcimi i gjuhëve tradicionale krahinore dhe të pakicave të saj, përfaqëson një kontribut në ndërtimin e Europës, e cila, sipas idealeve të shteteve anëtare të Këshillit të Europës, mund t'i ketë themelet vetëm në parimet pluraliste.

Efektivisht, Shqipëria nuk e ka nëshkruar ende Kartën Europiane të Gjuhëve Krahinore, ose Minoritare.

9. Informacion mbi propozimet dhe rekomandimet për çështjet e minoriteteve në vend.

Në kuadër të aktivitetit mbi respektimin e të drejtave të minoriteteve në vendin tonë, krahas trajtimit dhe shqyrtimit të ankesave individuale, Institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur dhe dërguar këto rekomandime kryesore, si më poshtë vijon:

- *Përmirësim dhe plotësim i kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve:*

1. *Rekomandim për disa përmirësime ligjore për përfshirjen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.*

Një liritë dhe të drejtat themelore, të garantuara në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit, dispozitë e cila, në kuadër të barazisë ndalon edhe diskriminimin e padrejtë për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, arsimit, gjendjes ekonomike a shoqërore, ose përkatësisë prindërore.

Hierarkia e akteve normative në vend që, garantojnë barazinë para ligjit ka njohur detajim adekuat me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ky ligj, veç përcaktimeve të dhëna për kuptimin e barazisë përcakton edhe elementët, mosrespektimi, apo veçimi i qëllimshëm i të cilave çon në diskriminim.

Në këtë kuptim mund të themi se, aktualisht ekziston në vend baza legjislative për sanksionimin e kësaj të drejte dhe lirie themelore e cila përfshin, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Konventat ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara nga vendi ynë, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli nr.12, i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe

Lirive Themelore të Njeriut “Për një ndalim të Përgjithshëm të Diskriminimit”, nënshkruar dhe ratifikuar në vitin 2010, Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, si një ligj kuadër që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, ku përcaktohen parimet, rregullat dhe masat e përgjithshme për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërkohë që aktet e tjera ligjore në fuqi rregullojnë në mënyrë të posaçme mosdiskriminimin, lidhur me ushtrimin e të drejtave të tjera specifike.

Bazuar në këtë qasje duhet theksuar fakti se, gjatë vitit 2012 e në vazhdim, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar e trajtuar një numër i madh ankesash nga individë të komuniteteve vulnerable si: anëtarë të minoritetit rom dhe persona nga aftësia e kufizuar, duke rezultuar si grupimet më të ekspozuara ndaj fenomenit të diskriminimit. Pavarësisht faktit që, këta individë pretendonin shkeljen e një të drejte të caktuar, rastet e shqyrtuara mbartin elementë të shkeljes së barazisë, ose të diskriminimit negativ, të cilat kanë shërbyer si shkak në shkeljen e të drejtave të tjera të pretenduara nga ankuesit.

Nuk kanë munguar këtu ankesa nga individë të tjerë jashtë këtyre grupimeve, gjatë shqyrtimit të të cilave është konstatuar e njëjta problematikë.

Në një këndvështrim analitik të problemit, konstatojmë se, neni 1, i Ligjit “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, parashikon një gamë më të gjerë shkaqesh se sa Kushtetuta, të cilat mund të çojnë në diskriminim, (parë kjo si një zhvillim pozitiv ky në drejtim të zhvillimit të standartit minimum të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut), por përsëri në të nuk janë parashikuar shprehimisht shkaqe, të cilat mund të çojnë në forma të caktuara diskriminimi.

Ankesat e shqyrtuara, por edhe rastet e bëra publike në media sidomos këto vitet e fundit, kanë nxjerrë nevojën e parashikime të sakta ligjore për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit dhe konkretisht për ndalimin e diskriminimit që bazohet në; kombësinë; një qëllimi të shpallur për të diskriminuar; nxitjes për diskriminim dhe ndihmesës dhe inkurajimit të diskriminimit. Efektivisht, shkaqet e cituara më sipër, nuk janë të parashikuara në Ligjin “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se në Ligjin “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duhet të shtohen në shkaqet për të cilat ndalohet diskriminimi edhe kombësia; qëllimi i shpallur për të diskriminuar; nxitja për diskriminim dhe ndihmesa dhe inkurajimi i diskriminimit.

Për sa më sipër, i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për realizimin e inisiativës legjislative, për disa përmirësime në nenin 1, të Ligjit nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.

Efektivisht pas përsëritjes së këtij rekomandimi në datën 23.12.2013, ka ardhur një përgjigje vetëm nga ana e Ministrisë së Drejtësisë (dt.30.01.2014), ku shprehet gatishmëria për bashkëpunim dhe asistencë në draftimin e ndryshimit të kërkuar, në koordinim edhe me institucionet e tjera përgjegjëse. Mungon përgjigja nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

2. *Për plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.*

Realitet vital i shoqërisë shqiptare kanë qënë dhe janë minoritetet etnike, kulturore, fetare, apo edhe gjuhësore, trajtimi i të cilave ka marrë një dimension të ri pas viteve 90', fakt ky që duket qartë në angazhimet që, shteti shqiptar ka ndërmarrë për këtë qëllim.

Nisur nga kjo frymë, për garantimin e të drejtave të minoriteteve, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është përcaktuar parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, pavarësisht përkatësisë së individit në një pakicë kombëtare.

Natyrisht që veç bazës tjetër ligjore në fuqi, rol parësor në këtë drejtim luan Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, e ratifikuar pa asnjë rezervë nga vendi ynë me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999.

Por, pavarësisht këtyre angazhimeve institucionale dhe parashikimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare që janë në fuqi, të gjithë jemi të vetëdijshëm, që ka shumë për të bërë, për të garantuar në praktikë, respektimin e të drejtave, integritimin dhe përfshirjen sociale, të minoriteteve që jetojnë në vendin tonë.

Konkretisht, në lidhje me minoritetet kombëtare evidentohet se, pavarësisht bazës normative ligjore në fuqi, mungon përkufizimi i minoritetit kombëtar.

Aktualisht procesi i njohjes së këtyre minoriteteve në vend, bazohet në kriteret e përcaktuara nga konventat ndërkombëtare, siç janë kriteret objektive që kanë të bëjnë me ekzistencën e karakteristikave etnike, kulturore, fetare, linguistike të veçanta dhe të qëndrueshme, nga pjesa tjetër e popullsisë të këtij grupi, si dhe me shfaqjen e vullnetit për të ruajtur kulturën, traditat, fenë, gjuhën e tyre, si dhe kriterin që nënkupton zgjedhjen personale për të qënë pjesë e minoritetit.

Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, siç përcaktohet edhe në Opinionet përkatëse të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, nuk është e vetëzbatueshme, por ka nevojë për adoptimin e masave të tjera ligjore dhe nënligjore për të bërë të mundur zbatimin e dispozitave të saj. Kjo Konventë nuk përcakton ndonjë përkufizim, në bazë të të cilit kryhet njohja e minoriteteve, por e lë këtë gjë në dëshirën e shteteve anëtare të Këshillit të Europës, që të kryejnë rregullimin e këtij aspekti nëpërmjet akteve ligjore të brendëshme, në varësi të konfigurimit respektiv të minoriteteve në çdo vend.

Aktualisht, siç edhe rezulton, vendi ynë nuk ka marrë ende “masën e nevojshme legjislative”, nxjerrë ende asnjë akt normativ të brendshëm ku të përcaktohet definicioni, apo kriteret e njohjes së minoriteteve, të cilat “de jure”, janë pranuar si të tilla indirekt nga shteti shqiptar, po t'i referohemi kriterëve të përzgjedhjes së anëtarësisë së Komitetit Shtetëror të Minoriteteve.

Në këto kushte është i nevojshëm rregullimi me një ligj specifik, i cili do të parashikojë shprehimisht këtë moment.²⁴

Sa më sipër, me qëllim garantimin sa më të mirë të të drejtave të minoriteteve në vend, i kemi sugjeruar në fillim të vitit 2013, ish Kryeministrit

²⁴ Në rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, përkatësisht Rezoluta 2019 (2014), në pikën 13.1 të saj, theksohet se Asambleja: “I rekomandon Kuvendit të Shqipërisë adoptimin e një sistemi më fleksibël dhe adekuat për njohjen e minoriteteve kombëtare dhe etnike”.

dhe në fund të po këtij viti Kryeministrit aktual, nevojën e realizimit të inisiativës legislative për miratimin e një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999.

Nga ana e zyrës së Kryeministrit është dërguar me shkresën nr.2389 datë 16.06.2014, një përgjigje ku shprehet se, analiza e këtij rekomandimi do të jetë objekt i punës së grupit ndërinstitucional, të ngritur në bazë të Urdhërit të Kryeministrit nr.117 datë 10.03.2014 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe politikave për minoritetet”. Ky grup funksionon prej disa muajsh dhe tashmë është në limitet kohore të dërgimit të rekomandimeve përkatëse, pranë kabinetit të Kryeministrit.

- *Përmirësimi i kushteve të jetesës së minoritetit Rom:*

1. Rekomandim mbi përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom në Shqipëri.

Përmbushja e detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom, me qëllim që ky minoritet të jetojë me standartet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, është në fokusin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit.

Pavarësisht se të drejtat e Romëve janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin vendas në fuqi një nga aspektet sensitive të gjendjes aktuale të minoritetit Rom në Shqipëri ka të bëjë me, kushtet e jetesës të komuniteteve Rome në ato qendra të cilat, njihen sot si qendra banimi të këtij komuniteti në pjesë të ndryshme të vendit. Duhet theksuar se, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që në rezultante konfigurohet me termin “cilësi e jetës”, term i cili prek drejtëpërdrejtë të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “e drejta për jetën”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Nga vizitat dhe inspektimet që, Institucioni ynë ka zhvilluar në disa nga këto qendra, si dhe nga ankesa të paraqitura nga individë pjestarë të këtij minoriteti, n’a rezulton se, kushtet e jetesës në këto qendra janë të vështira, pasi konkretisht, mungon lidhja e tyre me sistemin zonal të shpërndarjes së energjisë elektrike, me sistemin zonal të shpërndarjes së ujit të pijshëm, atë të kanalizimeve dhe mungon sistemi i rrugëve të brendshme. Ky fakt është evdidentuar edhe në një studim të realizuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, në fund të vitit 2011, nga UNICEF, në 108 komunitetet aktuale prezente të Romëve në Shqipëri. Qendrat kryesore të njohura të komuniteteve Rome sot janë, Fushë-Kruja, Tirana, Rrapishta në Elbasan, fshati Gosë në Kavajë, Fshati Rom në Fier, Peqini, Cërriku, Berati, Rrogozhina dhe më pak Korça dhe Bilishti...

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtij minoriteti e vërejtur në këto qendra banimi, por që nuk përjashton edhe vendbanime të tjera të këtij komuniteti është një problem serioz jo vetëm për këto komunitete, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që, ky minoritet të ndihet i diskriminuar, i pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Dokumenta strategjikë të formuluarë për këtë qëllim, siç edhe Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015, "Dekada e Përfshirjes së Romëve", japin disa rekomandime për përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të strehimit të popullsisë Rome, ku veçojmë; financimin me prioritet të ujësjellës-kanalizimeve në zonat e banuara nga Romët; financimin me prioritet të infrastrukturës rrugore dytësore në zonat e banuara nga Romët, masa këto që shkojnë në të njëjtën linjë me përmbushjen e kriterëve politike që, Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritimit në BE.

Megjithatë, sot evidentohet se është punuar pak, ose aspak në përmbushje të këtyre përgjegjësi, të cilat kërkojnë bashkërendim efikas të punës mes organeve të administratës publike, në nivelin qëndror dhe atë vendor, pa përjashtuar këtu rolin e pazëvendësueshëm të vetë komuniteteve Rome të interesuara.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jete më të mirë për minoritetin Rom në vendin tonë, specifikisht në zonat ku ndodhen qendrat e njohura të vendbanimeve të komuniteteve Rome, i kemi rekomanduar Ministrin të Punëve Publike dhe Transportit: "Marrjen e masave konkrete, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom dhe Planin Kombëtar të Veprimit 2010-2015, "Dekada e Përfshirjes së Romëve", për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, në një kohë sa më të shpejtë të mundshme".

Për këtë rekomandim nuk kemi ende një përgjigje, megjithëse është ridërguar në datë 23.12.2013.

2. Rekomandim për disa përmirësime ligjore, të cilat do të parashikojnë dhe garantojnë integritimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor, e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit.

Avokati i Popullit, në vijim të ushtrimit të funksionit të tij kushtetues, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, si një ndër prioritetet në punën e tij, veçanërisht në rastin e minoritetit Rom në Shqipëri, ka edhe ushtrimin dhe respektimin e së drejtës për arsimim e cila merr një rëndësi të veçantë, sidomos përsa i përket aksesit që, fëmijët e këtij minoriteti duhet të kenë në sistemin arsimor.

Theksojmë këtë moment pasi, barazia formale e sanksionuar në dispozitat e Kushtetutës, në realitet prezantohet si pabarazi, për shkak të një sërë rrethanash objektive dhe subjektive, të cilat kushtëzojnë realizimin efektiv të barazisë formale, rrethana këto që mund të çojnë edhe në diskriminim të tërthortë ndaj pjesarëve të këtij minoriteti.

Konkretisht, bazuar në ankesa të paraqitura pranë Institucionit tonë nga pjesëtarë të komunitetit Rom është konstatuar nga ana jonë fakti se, shumica e tyre ishte e pashkolluar, ose vetëm me arsimin fillor, si dhe është konstatuar se, fëmijët Rom nuk ndiqnin shkollën.

Për shkak të mungesës së arsimimit, për popullsinë Rome është i vështirë integrimi në tregun e punës, ndërkohë që kapaciteti numerik i saj do të rritet në të ardhmen, krahasuar me shumicën e popullsisë. Aktualisht, Romët janë grupet etnike më të varfëra dhe të marginalizuara në Shqipëri. Kjo gjë ka krijuar një rreth vicioz që prodhon analfabetizëm dhe arsimim të ulët mes Romëve, i cili thëllon edhe më shumë marginalizimin e tyre në shoqëri. Edhe pse krahasuar me disa vende të tjera në Europën Qendrore dhe atë Lindore,

Romët në Shqipëri përfaqësojnë një përqindje më të ulët të popullsisë, varfëria e tyre ekstreme në rritje ndikon negativisht kohezionin dhe stabilitetin social.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, arsimimi i pjesëtarëve të këtij minoriteti, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikase për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Niveli i ulët arsimor është problem serioz, që pengon integrimin e këtij komuniteti me shoqërinë. Shumica e fëmijëve Rom janë analfabetë dhe kjo për shkak të vështirësive gjuhësore që, kanë fëmijët në klasë të parë, të gjëndjes tejte të vështirë ekonomike të familjeve të tyre, të largësisë që kanë me vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore, si dhe të mentalitetit të gabuar të prindërve.

Karakteristikat e jetesës të familjeve romë kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës dhe mundësitë janë shumë më të kufizuara se, pjesa tjetër e popullsisë dhe si rezultat, sjellin një pamundësi ekonomike për të përballuar jetesën, si dhe një sërë problemesh sociale. Lëvizja e shpeshtë e tyre, nga një vendbanim në tjetrin, ka bërë që ata të mos përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale shtetërore, e për më tepër fëmijët e këtij minoriteti, jo vetëm që kanë braktisur bankat e shkollave, por dhe shfrytëzohen në rrugë për të lypur dhe për punë të rëndomta.

Rruga e duhur për të siguruar ndjekjen e vazhdueshme të sistemit arsimor të fëmijëve në pëgjithësi dhe fëmijëve Romë në veçanti është sanksionimi i ndjekjes së arsimit parashkollor dhe promovimi i ndjekjes në vazhdimësi i sistemit arsimor në vend, nga këta fëmijë.

Kuadri ligjor në fuqi është plotësuar së fundmi në këtë aspekt, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili mbulon sferën e edukimit parashkollor dhe arsimit shkollor, deri në momentin e kalimit në sistemin e arsimit të lartë. Por pavarësisht se ky ligj sanksionon barazi formale, nuk ekziston barazia thelbësore ndaj në këto kushte është detyrim i shtetit që të ndërmarrë masa pozitive, për të siguruar barazinë faktike dhe efektive të pjestarëve të minoritetit Rom në aksesin që, ata duhet të kenë në sistemin arsimor në vend, duke filluar nga arsimi parashkollor e në vazhdim.

Duhet theksuar se, marrja e këtyre masave shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kriterëve politike që, Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social ekonomike, ku përfshihet edhe minoriteti Rom. Njëkohësisht, adoptimi i këtij kuadri ligjor vjen në përputhje edhe me parashikimet e bëra në Planin Kombëtar të Veprimit, 2010-2015, Dekada e Përfshirjes së Romëve, përkatësisht me pikën 1, të pjesës 4.1.3, Rekomandime dhe veprime të ardhshme, të titulluar “Sigurimi i të drejtës së fëmijëve dhe të rinjve të minoritetit Rom për akses të barabartë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor”.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e së drejtës për arsimimin dhe aksesit të vazhdueshëm e me prioritet të pjesëtarëve të minoritetit Rom në sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë, i kemi rekomanduar Ministrit të Arsimit dhe Shkencës: Realizimin e inisiativës legjislative, për disa përmirësime në Ligjin nr.69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të cilat do të parashikojnë dhe garantojnë integrimin në arsim të fëmijëve Romë, nga niveli parashkollor, e deri në nivelet e tjera më të larta të arsimit.

Për këtë rekomandim nuk kemi ende një përgjigje.

3. Rekomandim për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike” (i ndryshuar) – (drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë).

Baza e rekomandimit: Në pikën 2, të nenin 52, të Kushtetutës përcaktohet se kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e përcaktuara me ligj. Ligji nr.9355, date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcaktojnë skemat e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore.

Arsyeja: Përgjatë periudhës Janar 2012 e deri më sot, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre pjesëtarë të komunitetit Rom, të cilët kanë ngritur ndër të tjera çështjen e përfitimit të tyre nga programet e mbrojtjes sociale. Minoriteti Rom, ka mënyrë të jetesës dhe kulturës së tij, lëvizjen e vazhdueshme nga një zonë në tjetrën. Në këto kushte bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi, bëhet i vështirë përfitimi i ndihmës ekonomike, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin përkatës që lidhen me ndryshimin e vendbanimit dhe procedurave që duhet të ndiqen për shkak të këtij ndryshimi.

Zgjidhja e rekomanduar: Ndërmarrja e iniciativës legjislative për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” (i ndryshuar), në kriteret e përcaktuara të ndihmës ekonomike, ndryshimet të cilat do të ndihmojnë për një periudhë tranzitore përthithjen në sistemin e mbrojtjes sociale të familjeve romë, si dhe integrimin social të tyre. Këto masa të veçanta të përkohshme, të kombinuara edhe me masat e tjera të sistemit të mbrojtjes sociale apo të politikave të punësimit për këtë komunitet, do të mundësojnë përmirësimin e situatës së këtij komuniteti, përmirësim ky i cili, do të sjellë edhe gradualisht shuarjen tyre.

Ende nuk kemi një përgjigje zyrtare përfundimtare lidhur me këtë rekomandim, pavarësisht procesit që aktualisht ka ndërmarrë Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për këtë qëllim.

4. Rekomandim për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual (drejtuar Ministrit të Brendshëm).

Baza e rekomandimit: Neni 15 i Kushtetutës, Ligji Nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” (i ndryshuar).

Arsyeja: Institucioni i Avokatit të Popullit, ka trajtuar problematika e njohur, ku pjesëtarë të komunitetit Rom të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme kanë ngritur shqetësimin, mbi sekuestrimin dhe ndalimin e mjeteve të punës së këtij komuniteti, nga Policia Bashkiake Tiranë, dhe ka ndërmarrë një proces vlerësimi të mënyrës se si mund të ndihmohet ky komunitet për t’u integruar dhe përthithur në sistemin e shoqërisë shqiptare. Ndryshimi i vendit të vendosjes së tyre në mënyrë të vazhdueshme, mungesa e dokumentacionit për të provuar qëndrimin e tyre në një territor të caktuar, mungesa e banesave në kuptimin e mirëfilltë, në shumicën e rasteve bëhet pengesë për regjistrimin e vendbanimit dhe më tej në privimin e tyre për të

përfitur nga programet e mbrojtjes sociale, punësimi, strehimi etj. Nga ankesat e paraqitura pranë Institucionit të Avokatit të Popullit është konstatuar se një pjesë e pjestarëve të komunitetit rom e tyre nuk kanë banesë në kuptimin e mirefillte të fjalës në territoret ku janë vendosur. Gjithashtu kemi konstatuar se, mungesa e informacionit, neglizhenca e indiferentizmi i tyre, si dhe mungesa e burimeve financiare për të ndjekur procedurat e siperpermendura ligjore, ka bërë që në shumë raste këta shtetas të mos figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre, apo të kenë ndryshuar atë pasi kanë lëvizur nga vendbanimi i parë.

Zgjidhja e rekomanduar: Ndërmarrja e iniciativës për ndryshime në Ligjin Nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, në mënyrë që brenda një afati të kufizuar kohor (të paktën deri në 31.12.2015), të lehtësohen nga afatet e parashikuara në ligj, si dhe t’u njihet mundësia e regjistrimit apo ndryshimit të vendbanimit edhe nëse nuk plotësojnë dokumentacionin e parashikuar për këtë qëllim, në gjendjen civile ku janë vendosur aktualisht. Ende nuk kemi një përgjigje zyrtare lidhur me këtë rekomandim.

Rekomandim ende pa përgjigje zyrtare.

5. Rekomandim legjislativ për ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar) - (drejtuar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit).

Baza e rekomandimit: E drejta për strehim, Neni 15 i Kushtetutës, ligji 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar).

Arsyeja: Gjatë gjithë periudhës Janar 2012 e deri sot, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre pjesëtare të komunitetit Rom, të cilët kanë ngritur, ndër të tjera çështjen e strehimit dhe përfitimit të tyre nga programet sociale të strehimit. Ata janë shprehur se jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike, duke mos plotësuar asnjë nga nevojat minimale të jetesës së përditshme. Shumica e tyre jeton nëpër baraka, ndërsa disa të tjerë nuk kanë asnjë strehë. Kriteret e përcaktuara për përfitim strehimi nga ana e pjestarëve të minoritetit Rom janë të paarrtshme nga ana e tyre, duke bërë që parashikimet e ligjit të mos mund të garantojnë në praktikë strehimin e familjeve të komunitetit Rom.

Zgjidhja e rekomanduar: Duke qënë se sipas parashikimeve ligjore në fuqi, pjestarët e komunitetit Rom do ta kenë praktikisht të pamundur të përfitojnë nga këto programe të strehimit, sugjerojmë që në ligjin 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), të parashikohen dispozita tranzitore të kufizuara në kohë, të cilat të konsiderohen si masa të veçanta të përkohshme për këtë komunitet, deri në momentin e përthithjes së tyre në sistem apo dhe të integritit të tyre social. Konkretisht:

1. Plotësimin dhe qartësimin e pikës 2 të nenit 4, pikës 1, të nenit 6 dhe pikës 1, të nenit 19, të ligjit 9232/2004, apo delegimin e rregullimit të çështjes së kufijve të të ardhurave me një akt nënligjor.

2. Në nenin 39/1, “Dispozita tranzitore”, të ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), sugjerojmë të shtohen përcaktime të cilat do të rregullojnë strehimin e qytetarëve romë, brenda një periudhe pak më shumë se 4-vjeçare. Me përfundimin e kësaj periudhe, ky afat duhet të rivlerësohet në përputhje me politikat qeveritare të përfshirjes sociale ndaj minoritetit Rom.

Afati i propozuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit, mund të vlerësohet nga institucioni juaj, mbi mundësinë e zbatimit të tij në praktikë, me qëllim integrimin në shoqëri të minoritetit rom.

Pikat të cilat propozojmë të shtohen janë:

“6.Njësitë e qeverisjes vendore deri në 31.12.2017, parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre, që jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom. Përcaktimi i kuotës mbi 5%, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore duke u bazuar në numrin e familjeve të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, që kanë paraqitur aplikim dhe plotësojnë kriteret për të përfutur nga programet sociale të strehimit.

7.Familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit, për të gjitha kriteret e parashikuara në nenin 5 të ligjit, si dhe për përparësitë apo pikëzimet e vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të këtij ligji, deri në 31.12.2017.

8.Përfitojnë nga programi i banesave sociale me qera, brenda kuotës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni, deri në 31.12.2017, familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, të cilat kanë të ardhura në nivelin e parashikuar në nenet 6 dhe 19 të ligjit.

9.Familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom, përfitojnë subvencion sipas nenit 24 të ligjit, në masën 100% të vlerës së qirasë. Kjo masë subvencioni, ulet për familjen përfutuese, në varësi të përfshirjes së anëtarëve të familjes në moshë pune, në programet aktive të nxitjes së punësimit. Masa e subvencionit që ulet, përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, në varësi të të ardhurave të familjes pas përfshirjes së anëtarëve të saj në programet aktive të nxitjes së punësimit.

10.Këshilli i Ministrave përcakton dokumentacionin që duhet të paraqesin familjet e komunitetit rom, për të përfutur nga programet sociale të strehimit, si dhe bonusin e strehimit.”

Ka një përgjigje zyrtare lidhur me këtë rekomandim nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit me shkresën nr.2872 datë 11.06.2014, ku pas një analize të gjatë dilet në konkluzionin se, problematika e minoritetit Rom nuk qëndron tek ligji 9232/2004 i ndryshuar, pasi ai garanton të drejtën e strehimit edhe për individët Romë, por është një çështje shumë më komplekse.

9. Konkluzione dhe Rekomandime:

a) Konkluzione:

1. Ekzistenca e minoriteteve në Shqipëri është një realitet sa historik aq edhe aktual, të cilit i është kushtuar një vëmendje e veçantë për të konkretizuar një marrëdhënie të mirë, ku shprehet toleranca, bashkëjetesa dhe mirëkuptimi mes pjeshtarëve të pakicave përkatëse dhe pjesës tjetër të popullatës. Me vendosjen e demokracisë në vend, trajtimi i pakicave ka marrë një dimension të ri, fakt që duket qartë në angazhimet që shteti shqiptar ka ndërmarrë për këtë qëllim.
2. Sot në Shqipëri njihen dy lloje minoritetesh, minoritetet etnike kombëtare ku përfshihet minroteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazez, si dhe minoritetet etno gjuhësore, ku

përfshihen minoriteti Vllah dhe minoriteti Rom. Ekzistojnë edhe disa komunitete të tjera të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare, siç janë komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian, apo edhe komuniteti Goran. Veçanërisht komunitetet e tjera, rezultojnë të jenë në një fazë kur kanë realizuar disa të drejta që efektivisht u takojnë minoriteteve zyrtarisht të njohura në Shqipëri, ndërkohë që ato nuk gëzojnë këtë status, si dhe kur ato kërkojnë të marrin statusin e minoritetit, por pa mundur të orientohen ligjërisht për rrugën që duhet të ndjekin.

3. Aktualisht mungon një përkufizim i përgjithshëm mbi minoritetet në aktet ndërkombëtare. Megjithatë mungesa e këtij përkufizimi nuk ka penguar shtetet e ndryshme, sikurse edhe vendin tonë të njohin kategori të caktuara minoritetesh bazuar në tregues të natyrës objektive dhe subjektive të komuniteteve të caktuara në vend.
4. Njohja e minoriteteve nxjerr nevojën e mbrojtjes së tyre, përmes afirmimit të një sërë të drejtave që u njihen posaçërisht minoriteteve. Në vendin tonë këto të drejta janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në një sërë aktesh të tjera ndërkombëtarë të nëshkruara, apo të ratifikuara nga ana e shtetit, si dhe në kuadrin ligjor aktual në fuqi. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.
5. Sfidat e ndeshura në implementimin e të drejtave të pakicave janë të shumta. Ato fillojnë që nga mundësia reale e vetë institucionit të Avokatit të Popullit për të qënë prezent në mënyrë të vazhdueshme dhe të ndjeshme pranë tyre, aty ku ato ndodhen; të krijimit të besimit të ndërsjellë mes aktorëve që veprojnë në këtë fushë; të ndryshimit të mentalitetit, lidhur me pranimin e realiteteve të reja dhe respektimin e të drejtave të individëve që i përfaqësojnë ato; të krijimit të një ambienti të përshtatshëm institucional që mundëson barazinë reale të individëve pjeshtarë të minoriteteve të ndryshme me pjesën tjetër të popullsisë në vend dhe të integritit të tyre.
6. Elementët më kryesorë në zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare janë dialogu konstruktiv dhe i vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi ndërkulturor ndërmjet, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe qytetarëve, me qëllim që adresimi i problematikave dhe procesi i analizimit dhe zgjidhjes së tyre të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar. Kjo mënyrë mendimi dhe veprimi n’a afron gjithnjë e më shumë me komunitetin European, ku edhe aspirojmë të anëtarësohemi së shpejti.
7. Avokati i Popullit vlerëson si prioritet mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Vizioni i tij bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.
8. Pavarësisht hapave pozitivë në kuadër të miratimit të një baze normative sa më afirmuese mbi të drejtat e minoriteteve, ndjehet nevoja e përmirësimit dhe pasurimit të këtij legjislacioni.²⁵

²⁵ Kjo nevojë shprehet edhe në pikën 13, të Rezolutës 2019 (2014), të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

9. Efektivisht sot, pavarësisht proceseve të regjistrimit të popullsisë të ndërmarrë nga ana e shtetit, (përfshirë këtu censusin e vitit 2011), gjendemi para faktit të një debati mes deklaramit zyrtar të shifrave të popullsisë minoritare në vend dhe nga ana tjetër të mospranimit dhe kontestimit të tyre nga ana e vet minoriteteve. Ky moment konstaton mungesën e të dhënave të sakta statistikore mbi popullsinë minoritare, të dhëna këto që të jenë të pranueshme nga të gjitha palët.
10. Bazuar në të drejtat e minoriteteve të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet bazë ndërkombëtare, siç edhe Konventa Kuadër e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, nga informacioni i mbledhur për këtë raport rezulton se;
- Perceptimi i përgjithshëm që ekziston tek minoritetet dhe komunitetet e tjera që ekzistojnë në vend është se, barazia formale ekziston por ka elementë të jetës së përditëshme të cilat identifikojnë mungesën e barazisë thelbësore.
 - Njohja e akteve normative që garantojnë të drejtat e minoriteteve shfaqet në nivelin jo të kënaqshëm.
 - Sa i takon masave që duhet të marrë shteti për ruajtjen e identitetit të minoritetit, (kuptuar këtu masat për ruajtjen e zhvillimin e kulturës, besimit fetar, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore), identifikohet se nga ana e shtetit janë marrë përgjithësisht masa, por ato konsiderohen ende të pamjaftueshme nga ana e minoriteteve.
 - Pjesëmarrja në sistemin arsimor shtetëror është e lire dhe pa pengesa. E njëjta situatë shfaqet edhe në ushtrimin e lirisë së tubimit, organizimit në shoqata, apo të shprehjes së ndërgjegjes dhe besimit fetar. Konstatohet gjithashtu përdorim i lirshëm i gjuhëve minoritare apo edhe i informacioneve personale, në jetën e përditëshme. Kontaktet me personat e tjerë të së njëjtës kombësi, apo të kombësive të tjera jashtë kufirit, janë të lira.
 - Ekzistenca e shtypit të shkruar dhe mediave audiovizive lokale në gjuhën minoritare, vërehet se ka mungesa që vijnë kryesisht për shkak të mosfinancimit të tij nga ana e shtetit dhe aftësive të pakta që realisht ekzistojnë, për financimin e tij nga ana e individëve privatë.
 - Sa i takon përfshirjes së njohurive në tekstet shkollore shtetërore mbi minoritetet në vend, konstatohet se, përfshirja është e pakët dhe e pamjaftueshme dhe se jo të gjithë fëmijët minoritarë, marrin mësim në sistemin shtetëror arsimor, në gjuhën e tyre amtare. Shkollat me sistem dygjuhësh ekzistojnë, por jo për të gjithë minoritetet dhe ato janë të nivelit nëntëvjeçar.
 - Të drejtat që fëmijët në minoritete dhe komunitete të tjera duhet të gëzojnë specifikisht, për shkak të origjinës së tyre dhe përkatësisë së ndryshme në elementët që trajtojnë diversitetin kulturor dhe gjuhësor nga pjesa tjetër e popullsisë mazhoritare jo adulte, respektohen, por sikurse kemi theksuar në Raportin e veçantë për gjendjen e minoritetit Rom, mbetet problematik shfrytëzimi i fëmijëve të këtij minoriteti për punë, ndjekja e procesit arsimor, si dhe rastet e trafikimit (Shih raportin e sipërcituar, bashkëngjitur këtij raport).

b) Rekomandime:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e minoriteteve mbetet një nga çështjet kryesore, pasi vërehen mangësi. Në këtë kuadër është i nevojshëm miratimi i një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999.
- Është i nevojshëm fillimi dhe përfundimi i procesit për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose Minoritare.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin 1, të Ligjit nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.
- Marrja e masave adekuate dhe zgjerimi i mundësive për edukimin e minoriteteve, duke përfshirë mësimin e gjuhëve minoritare, promovimin e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së minoritetit.
- Marrjen e masave konkrete ligjore dhe administrative për përmirësimin e aksesit në strehim, shërbimet e arsimit shërbimet sociale dhe pjesëmarrjen në jetën publike veçanërisht të minoritetit Rom, por edhe të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend. Integrimin real të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditëshme, veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qëndror.
- Garantimin e të drejtave të minoriteteve, dhe marrjen e masave për respektimin e tyre në jetën e përditëshme dhe mbrojtjen e popullsisë vulnerabël.
- Zhvillimi i një dialogu konstruktiv dhe të vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi ndërkulturor ndërmjet, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe pjestarëve të minoriteteve, me qëllim që, adresimi i problematikave dhe procesi i analizimit dhe zgjidhjes së tyre të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar.
- Realizimi i një procesi të regjistrimit të popullsisë (censusi), të pakontestuar dhe të gjithëpranuar edhe nga minoritetet dhe komunitetet e tjera, i cili do të jepte shifrat reale të popullsisë minoritare, apo edhe të komuniteteve të tjera.
- Krijimi i kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe komunitetet e tjera, përfshirë këtu edhe financimin me një buxhet më adekuat për njësitë e qeverisjes vendore, ku ka komunitete minoritare dhe komunitete të tjera në një masë dalluese me pjesën tjetër të popullsisë mazhoritare.

- Rritja e rolit dhe veprimtarisë së të gjithë institucioneve shtetërore në kuadër të respektimit të të drejtave të minoriteteve, veçanërisht zgjerimi i aktivitetit të institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe mbështjetja e tyre në funksion të afirmimit, njohjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve.